



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 23 (827775)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 10 Qershor 2022

MINISTRI I MBROJTJES, VIZITË ZYRTARE NË GREQI

Ministri Peleshi: Sfidat e sigurisë së përbashkët intensifikojnë bashkëpunimin mes palëve



»» faqe 2

Greçia dhe Shqipëria gati të rinovojnë marrëveshjen në fushën e Emergjencave Civile

Shqipëria dhe Greçia kanë rënë dakord të rinovojnë një marrëveshje për forcimin e bashkëpunimit...

»» faqe 2

MË 4 QERSHOR 2022

BAJRAM BEGAJ

ZGJIDHET PRESIDENT

I 9-të I SHQIPËRISË

NGA 24 KORRIKU, KOMANDANT I PËRGJITHSHËM I FA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI:

I bindur se në krye të shtetit kemi zgjedhur një njeri me vlera qytetare, që do të dijë të mbrojë Kushtetutën dhe ligjin

»» faqe 3



Zjarri në Sazan, Shqipëria mbështetet nga Mekanizmi i Mbrojtjes Civile i BE-së

Pas 48 orësh operacioni i intensifikuar për vënien në kontroll dhe fikjen e zjarrit në ishullin e Sazanit, është bërë e mundur vendosja në kontroll dhe në perimetër, u vlerësua e nevojshme ndërhyrja nga ajri. Për këtë qëllim...

»» faqe 2

INTERVISTË ME GJENERAL BRIGADE EDITSON ZARKA



E drejta e informimit dhe sigurisë kombëtare në optikën e transparencës së publikut

INTERVISTOI: SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE, ANJEZA MUSOLLARI

Gjeneral brigade Editson Zarka përfundoi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", dhe më tej në Akademinë Ushtarake, në degën "Radiolokacion Zbulim i Largët", duke u titulluar oficer aktiv në radhët e Forcave...

»» faqe 6-7

Ministri i Mbrojtjes, vizitë zyrtare në Greqi

Ministri Peleshi: Sfidat e sigurisë së përbashkët intensifikojnë bashkëpunimin mes palëve

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi zhvilloi një vizitë dyditore në Greqi, me ftesë të homologut të tij Nikolaos Panagiotopoulos. Biseda mes dy ministrave u përqendrua te sfidat aktuale të sigurisë, me fokus të veçantë mbi situatën në Ukrainë, pasojat e mundshme mbi sigurinë në rajon, procesin e integritimit Euro-Atlantik dhe angazhimet e përbashkëta në kuadër të NATO-s dhe rajonit. Takimi ndërmjet dy delegacioneve u zhvillua në një frymë tepër miqësore, ku u ndanë mendimet dhe idetë e tyre për të zhvilluar dhe intensifikuar më tej bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes, duke u fokusuar në fushat e arsimit dhe edukimit ushtarak, shëndetësi, stërvitjet e përbashkëta si dhe angazhimet në rajonin e Ballkanit.

Peleshi shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vijueshme që Greqia i ka dhënë Shqipërisë, jo vetëm gjatë procesit të anëtarësimit në NATO, por edhe në përpjekjet që vendi ynë po bën për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian. Të dy ministrat vlerësuan kontributet respektive në angazhimet në kuadër të Aleancës si edhe shprehën gatishmërinë për të mbështetur vendimet dhe angazhimet që priten të konfirmohen në Samitin e NATO-s në Madrid, Spanjë. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi rikonfirmoi vijimin e angazhimeve të vendit tonë në NATO, duke vënë në dukje shtimin e kontributeve të Shqipërisë në kuadër të



misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, në eFP (enhanced Forward Presence), në Letoni si dhe angazhimin për të kontribuar me një togë në eFP Bullgari.

Nga të dyja palët u dënua njëzëri agresioni i paprovokuar i Rusisë në Ukrainë, ndërsa shprehën qëndrimin e tyre ndaj

ndikimeve të kësaj situatë në Ballkan, Europë e më gjerë. Ministri Peleshi u shpreh se: "Sfidat tona të sigurisë mbeten të përbashkëta, të pandashme dhe të gjithanshme. Ato vijnë nga çdo drejtim dhe mund të cenojnë sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë dhe më



gjerë. Nuk duhet të humbasim vëmendjen nga rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe krahu jugor i Aleancës".

Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë vlerësoi kontributin e Forcave të Armatosura greke që prej fillimit në misionin e KFOR-it, në Kosovë, si një kontribut

të madh për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Sipas ministrit Peleshi, mbështetja e pjesëmarrjes së Kosovës në iniciativat rajonale (SEDM, etj.) do të jetë një hap tepër i rëndësishëm në shërbim të rritjes së besimit, paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon.

Greqia dhe Shqipëria gati të rinovojnë marrëveshjen në fushën e Emergjencave Civile

Shqipëria dhe Greqia kanë rënë dakord të rinovojnë një marrëveshje për forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e Emergjencave Civile, në një kohë që të dy vendet kanë nisur të përballen me problematika të tilla si zjarret dhe ndërkohë që vendi ynë është i vendosur për të rritur dhe modernizuar kapacitetet reaguese.

Gjatë vizitës zyrtare dyditore në Greqi, ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u takua me zëvendësimin e Mbrojtjes Civile dhe Emergjencat Klimaterike.

Ministri Peleshi falënderoi vendin fqinj për mbështetjen e dhënë në rastin e tërmetit tragjik të vitit 2019, gjatë pandemisë së COVID-19 si dhe në ndihmën për fikjen e vatrave të zjarrit në vendin tonë, jo vetëm gjatë verës së shkuar, por edhe për ndihmën e dhënë përmes Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së në shuarjen e zjarrit në Sazan.

Në të njëjtën kohë, z. Peleshi shpalosi synimet e Ministrisë së Mbrojtjes për të rritur kapacitetet në fushën e Emergjencave Civile si dhe shprehu vlerësimin e tij për kontributin e Greqisë në këtë drejtim.



Zjarri në Sazan, Shqipëria mbështetet nga Mekanizmi i Mbrojtjes Civile i BE-së

Pas 48 orësh operacioni i intensifikuar për vënien në kontroll dhe fikjen e zjarrit në ishullin e Sazanit, është bërë e mundur vendosja në kontroll dhe në perimetër, u vlerësua e nevojshme ndërhyrja nga ajri. Për këtë qëllim, avion tip "Canadair CL 415", i cili erdhi nga fqinji ynë Greqia, u aktivizua për shuarjen nga ajri të zjarrit në ishullin e Sazanit. Avioni "Canadair CL 415" hyri në operacion për shuarjen e zjarrit nga ajri si mbështetje e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian (Emergency Response Coordination Centre - ERCC), pas kërkesës së bërë nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Shteti Grek iu përgjigj menjëherë pozitivisht kërkesës së shtetit Shqiptar. Ekspertët vlerësuan se është e nevojshme ndërhyrja nga ajri për shuarjen e flakëve në një terren tejet të vështirë, ku me gjithë punën e palodhur të Forcës Tokësore nuk është arritur të izolohen të gjitha vatrave. Pavarësisht ndërhyrjes nga ajri, puna në terren dhe krijimi i brezit të shpyllëzimit mbeten thelbësore për izolimin total të zjarrit në një zonë të ish-repartit ushtarak. Avioni "Canadair CL - 415" është projektuar posaçërisht për shuarjen e zjarrit nga ajri, por ai mund të kryejë edhe role të tjera të ndryshme, të tilla si kërkim-shpëtimi dhe transporti. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili ndodhej për një vizitë zyrtare në Greqi, pas një sërë kontaktesh falënderoi autoritetet atje për përgjigjen në kohë ndaj Shqipërisë.

MË 4 QERSHOR 2022

Bajram Begaj zgjidhet President i 9-të i Shqipërisë

NGA 24 KORRIKU, KOMANDANT I PËRGJITHSHËM I FA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm, sot Komandant i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, lider-shipi vizionar nën drejtimin e të cilit u realizuan transformime në strukturat e FA-së, drejt arritjes së përsosmërisë së sistemit akademik ushtarak, modernizimit të infrastrukturës në sisteme dhe pajisje. Me një karrierë të gjerë ushtarake, dhe jo vetëm.

Për audiencën e gjerë kush është z. Bajram Begaj?

Gjeneralmajor Bajram Begaj ka lindur më 20 mars 1967, në Rrogozhinë. Në vitin 1989, gjeneralmajor Begaj ka përfunduar studimet pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Dega Mjekësi e Përgjithshme dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin “Mjekësi” në vitin 1998.

Përpara se të merrte detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, për një periudhë trevjeçare ka shërbyer në detyrën e komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes.

Begaj, i cili ka një karrierë më shumë se 30-vjeçare në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, prej vitit 2020 shërben në rolin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Më parë ai ka shërbyer në disa poste të rëndësishme si Komandant i



Komandës së Stërviçjes dhe Doktrinës.

Gjatë karrierës së tij ushtarake, gjeneralmajor Bajram Begaj ka shërbyer në pozicione të ndryshme drejtuese në Forcat e Armatosura, si: zëvendës-

drejtor i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”; drejtor i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar; drejtor i Inspektoratit Shëndetësor, kryeinspektor dhe këshilltar i

Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së; shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe zëvendësdrejtor i Spitalit Universitar të Traumës, si dhe detyra të tjera në strukturat e

Forcave të Armatosura.

Gjeneralmajor Begaj ka ndjekur kualifikime dhe specializime të ndryshme në fushën ushtarake dhe atë mjekësore, në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit. Ai ka përfunduar Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, Shkollën e Thelluar Pasuniversitare të Mjekësisë dhe specializimin pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji, pranë Fakultetit të Mjekësisë Tiranë.

Gjithashtu ka ndjekur kursin e menaxhimit spitalor dhe kursin e lidershit mjekësor strategjik, në SHBA, Kursin e Lartë Ndërkombëtar të Menaxhimit të Mbrojtjes, pranë Institutit të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në SHBA, Seminarin e Lartë Ekzekutiv pranë Qendrës Marshall, Gjermani, si dhe kurse e kualifikime të tjera ushtarake. Gjeneralmajor Bajram Begaj, ka përfunduar “Doktoratën në Fushën e Mjekësisë”, pranë Fakultetit të Mjekësisë si dhe mban titullin “Profesor i Asociuar” në Mjekësi. Njëkohësisht është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij ushtarake.

Peleshi: I bindur se në krye të shtetit kemi zgjedhur një njeri me vlera qytetare, që do të dijë të mbrojë Kushtetutën dhe ligjin



Me rastin e zgjedhjes së z. Bajram Begaj në postin e presidentit të Republikës së Shqipërisë, ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi do t'i dërgonte një mesazh urimi ku mes të tjerash do shprehte për zemërsisht bashkëpunimin e tyre. “Urime të përzierme Bajram Begajt në detyrën më të lartë, si President i Republikës së Shqipërisë. Pata kënaqësinë të punoja me gjeneralmajor Begajn si shef i Shtabit të Forcave të Armatosura dhe jam besimplotë që atë bashkëpunim të mirë do të vazhdojmë ta kemi edhe si President dhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. I bindur se në krye të shtetit kemi zgjedhur një njeri me vlera qytetare, që do të dijë të mbrojë Kushtetutën dhe ligjin. Sukses Presidentit të ri të vendit!

Operacionet e kërkim-shpëtimit, bashkëpunim, përpjekje dhe angazhim ndërinstytucional

Operacionet e kërkim-shpëtimit janë operacione komplekse, të cilat kërkojnë bashkëpunimin dhe angazhimin e kapaciteteve të shumë institucioneve, me qëllim që, në kohën e duhur, të ndërhyhet për gjetjen, shpëtimin dhe evakuimin e personave në rrezik për jetën.

“Ministria e Mbrojtjes, si institucioni përgjegjës për administrimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit dhe zbatimin e politikave në këtë fushë, ka qenë e angazhuar në rritjen e kapaciteteve dhe hartimin e përditësimit të politikave, planeve dhe procedurave”, -tha në një prononcim për shtypin ushtarak nënkolonel Vasil Taçi, shef sektorit të Planëzimit dhe nënkryetar i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

Në zbatim të VKM nr. 729, datë 13.11.2019 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të tij”, i planëzuar në matricën e aktiviteteve kryesore të FARSH për vitin 2022, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura, zhvilloi kursin e gjuhës angleze në terminologjinë e operacioneve të Kërkim-Shpëtimit (SearchandRescue-SAR).

Në ambientet e Qendrës së Gjuhëve të Huaja për të ndjekur këtë kurs u ulën



14 efektivë të përzgjedhur nga struktura e FARSH, të cilët kanë deklaruar kapacitete SAR. FARSH, së bashku me institucionet e tjera shtetërore, kanë zhvilluar një sërë operacionesh të kërkim-shpëtimit, të cilët kanë nxjerrë në pah mundësitë e kapaciteteve tona ushtarake, por edhe mangësitë dhe hapësirat për përmirësim. Ato kanë demonstruar aftësi dhe kapacitet, duke nxjerrë në pah edhe nevojën për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet strukturave shtetërore.

Qëllimi i zhvillimit të këtij kursi ishte njohja dhe unifikimi i komunikimit dhe terminologjisë së përdorur në operacione të përbashkëta SAR, e ndërthurur kjo me njohjen e literaturës ndërkombëtare

për operacione të tilla. Kursi i drejtuar nga pedagoge Alma Cenka harmonizoi leksionet, videot e operacioneve SAR të zhvilluara nga FARSH dhe homologët e huaj të kësaj fushe, me takim dhe prezantime në bazën e helikopterëve Farkë, ku komandanti i saj N/kolonel Julian Dulemata sqaroi në mënyrë tepër profesionale misionin, detyrat dhe rolin e bazës në operacione SAR.

Objektivat afatgjatë të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit janë rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional, thellimi i mëtejshëm i ideve për zhvillimin e kapaciteteve, përmirësimin e strukturave, rritjen e gatishmërisë operacionale, trajnimin dhe kualifi-



kimin e personelit, si dhe përdorimin e integruar të kapaciteteve të kërkim-shpëtimit.

Kursi i parë SAR do të hedhë hapat për ndërtimin e një databaze për efektivët e këtij shërbimi, të cilët do të jenë pjesë e një seri trajnimesh në këtë fushë

dhe do të finalizohet me certifikimin e efektivëve, jo vetëm të FARSH por të gjithë kapaciteteve njerëzore kombëtare të cila duhet të konsolidohen në nivelet e kërkua nga organizatat ndërkombëtare ICAO dhe IMO, pjesë e të cilave është edhe vendi ynë.

Certifikimi

Forca TOKËSORE



Kursi i “Luftës në Qendrat e Banuara”, u zhvillua për rreth pesë javë në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale. I konsideruar si një nga kurset me ngarkesë të lartë psikologjike dhe fizike, kursi i LQB nga 24 pjesëmarrës certifikoi vetëm 12 në përfundim të tij.

Ceremonia

Certifikohen 12 komando të kursit “Lufta në Qendrat e Banuara”

Uzhvillua në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore (FT), ceremonia e përfundimit të Kursit të “Luftës në Qendrat e Banuara” (LQB), i zhvilluar me efektivët e Batalionit Komando.

Në aktivitetin, i cili u hap me një mësim tregues nga personeli komando, pjesë e kursit LQB, ku ata demonstruan disa nga temat e zhvilluara gjatë kursit, mori pjesë edhe komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i ROS kolonel Arben Zani, përfaqësues nga Shtabi i FT dhe i ROS.

Gjatë zhvillimit të demonstrimit, gjeneral brigade Kingji u njoh nga instruktorët turq të cilët zhvilluan këtë trajnim, mbi ecurinë, problematikën dhe temat kryesore që ata trajtojnë me kursantët komando. Me tej, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, duke përshëndetur të pranishmit, falënderoi të gjithë kur-



santët për angazhimin, disiplinën, profesionalizmin dhe vendosmërinë e treguar gjatë gjithë periudhës së kursit LQB.

Duke e vlerësuar si një nga kurset më të mira profesionale për trupat

komando, ai u shpreh i bindur se me përfundimin e këtij kursi, efektivët janë më të kompletuar dhe më të përgatitur nga ana profesionale, për t’iu përgjigjur çdo sfide apo situatë.



Komandanti i Forcës Tokësore, shprehu përgëzimet dhe mirënjohjen e tij edhe për instruktorët ushtarakë turq, të cilët organizuan dhe drejtuan kursin LQB. Gjeneral brigade Kingji e vlerësoi punën e mirë nga ana e tyre duke iu akorduar edhe Certifikatat e Mirënjohjes. Ceremonia vijoi me ndarjen e certifikatave për kursantët

dhe u mbyll me një foto të përbashkët. Kursi i “Luftës në Qendrat e Banuara”, u zhvillua për rreth pesë javë në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale. I konsideruar si një nga kurset me ngarkesë të lartë psikologjike dhe fizike, kursi i LQB nga 24 pjesëmarrës certifikoi vetëm 12 në përfundim të tij.

"Miqësi nëpërmjet Sportit" (Friendship through Sport)

Kampionati i futbollit në Forcat e Armatosura, 2022

Forca Tokësore fiton kupën e kampionatit të futbollit në FARSH

Në mjediset e Garnizonit "Skënderbej", në Ministrinë e Mbrojtjes, u zhvillua ceremonia përfundimtare e Kampionatit të Futbollit të Forcave të Armatosura për vitin 2022, në të cilën morën pjesë tetë ekipet më të mira të futbollit në FA, duke filluar nga Forca Tokësore, Forca Ajrore, Forca Detare, Akademia e Forcave të Armatosura, Komanda Logjistike, ASNI, Policia Ushtarake dhe AISM.

Ceremonia u përshëndet nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ku të pranishëm ishin ekipet pjesëmarrëse si dhe komandantët e forcave, gjeneralë, oficerë dhe ushtarakë të tjerë etj.

Në përshëndetjen e saj drejtuar pjesëmarrësve në këtë aktivitet sportiv, gjeneralmajor Shehu vuri theksin se këto aktivitete i shërbejnë rritjes së frymës së kolektivitetit dhe shpirtit të garës, tipare këto që karakterizojnë Forcat e Armatosura, për arritjen e synimeve dhe objektivave për realizimin e detyrave. "Sfidat që i paraqiten ushtarakëve dhe FA-ve për përmbushjen e detyrave kërkojnë përgatitje të lartë fizike, të motivuar, ndjenjë të lartë solidariteti dhe kondicion të mirë fizik, gjë që e treguan edhe në këtë aktivitet sportiv dhe për këtë jam shumë mirënjohës për çdonjërin nga ju", -tha ndër të tjera gjeneralmajor Shehu.

Kampionati i futbollit është një aktivitet sportiv i përvitshëm, i cili përveç rëndësisë që ka në përgatitjen fizike të trupave, përcjell dhe mesazhin "Miqësi nëpërmjet Sportit" (Friendship through Sport).

Kampionati aktivizoi mbi 150 efektivë/futbollistë që të gjithë efektivë ushtarakë dhe civilë të FA-së.

Vendin e parë në kampionatin e futbollit të FARSH për vitin 2022 e fitoi ekipi i komandës së Forcës Tokësore, vendin e dytë Forca Detare, vendin e tretë Akademia e Forcave të Armatosura, e cila fitoi dhe kupën e "FAIR-PLAY". Në mbyllje të aktivitetit sportiv u shpërndanë certifikata dhe medalje për fituesit.

Kampionati dhe Ceremonia

"Në zbatim të Plan Kalendarit të Aktiviteteve Sportive, për vitin 2022, në garnizonin "Skënderbej", janë zhvilluar ndeshje të aktivitetit sportiv, Kampionat i Futbollit i Forcave të Armatosura në FARSH, një kampionat tërësisht ushtarak, ku sipas traditës tashmë, ky kampionat



është bërë një ndër sportet më popullore dhe me të bukur nga rreth 15 aktivitetet sportive që zhvillohen në FARSH, për çdo vit kalendarik", -tha major Gernat Qirici, specialist i Përgatitjes Fizike në drejtorinë e Operacioneve dhe Stërvitjes, i cili në fjalën e rastit, pasi përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit, vuri theksin se nëpërmjet aktiviteteve sportive, pjesë e së cilës është edhe kampionati i futbollit në FARSH, harmonizohen më së miri përfitimi i cilësive të forcës, rezistencës, shkathësisë dhe shpejtësisë, aftësi që ushtaraku duhet t'i zotërojë për përballimin e stresit mendor dhe emocional në stërvitje detyrë dhe operacion. Gjithashtu sporti, -tha ai,

-i shërben më së miri forcimit të miqësisë së ushtarakëve, nëpërmjet tij rritet bashkëpunimi, familjarizimi dhe respekti reciprok në familjen e madhe të FARSH.

Këtë vit, Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes, e konceptoi aktivitetin si fillim me 2 grupe x 4 ekipet që do të luanin ndeshjet e tyre me sistem rrethi, me grumbullim pikësh dhe më pas me sistem eliminimi", -shpjegoi më tej major Qirici.

Në këtë kampionat janë aktivizuar mbi 150 efektivë/futbollistë, që të gjithë efektivë ushtarakë dhe civilë të Forcave tona të Armatosura. Në të janë përfshirë 8 ekipet më të mira të futbollit në FA, duke filluar nga Forcat Tokësore, Forcat

Ajrore, Forcat Detare, Akademia e Forcave të Armatosura, Komanda Logjistike, ASNI, Policia Ushtarake dhe AISM.

"Çdo ditë, çdo ekip, çdo komandë Force/Mbështetëse dhe strukturat e tjera shpalesën aftësitë dhe taktikat ku në fund të këtij kompeticioni fati i buzëqeshi Forcës Tokësore, mbas gjuajtjeve të penalltive nga ku përballa direkt me Forcën Detare u mbyll 0-0. Forca Tokësore-Forca Detare, ishte një nga finalat më të mira të zhvilluara deri tani".

Kualifikimi

Ekipi Fitues, Forca Tokësore, fitoi kupën e kampionatit të futbollit në FARSH për vitin 2022; Forca Detare, ekipi final-

ist zuri vendin e dytë dhe Akademia e Forcave të Armatosura, u kualifikua në vendin e tretë si dhe fitoi Kupën e FAIR-PLAY. Trajneri më i mirë u shpall Enkele Likaj AFA; Përgjegjës ekipi më i mirë, major Haxhi Shira FT; Mbrojtësi më i mirë kapitenlejtënant Andi Gjeçi FD; Lojtari më i mirë kapiten Marjus Braculla FT, të cilit iu dhurua nga FARSH një kostum sportiv; Golshënuesi më i mirë Briked Riba FD, të cilit iu dhurua nga FARSH një top futboll; Portieri më i mirë Gerald Bukri FT dhe Mesfushori më inteligjent, Gramoz Abedini AISM. Në fund efektivët e Forcës Tokësore festuan titullin e Fituar, Titullin KAMPION.

Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios eliminojnë rrezikun e municionit të gjetur tek sheshi Shqiponja, Tiranë

Specialistët xhenierë të grupit EOD, nën masa të rrepta sigurie arritën të largonin nga sheshi Shqiponja një municion topi E-TH 152 mm të paplasur. Edhe pse kjo punë është punë rutinë për këtë grup, vlerësimi nga ana e tyre i këtij municioni bëri të mundur përfundimin me sukses të kësaj detyre.

Ky municion u transportua dhe u magazinua në depot e Batalionit të Xhenios për asgjësimin në një moment të dytë sipas rregullave të sigurisë.

Komanda Mbështetëse ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në vite, jo vetëm në shërbim të misionit të Forcave të Armatosura për pastrimin e asgjësimin e municioneve të paplasura por edhe në shërbim të komunitetit.



AFA, fituese e vendit të parë në 10 km

Në qytetin e Vlorës u zhvillua Maratona e këtij qyteti, me gjatësi 10 km. Në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Vlorë, morën pjesë rreth 200 garues, ndërkohë që edhe Akademia e Forcave të Armatosura u përfaqësua me ekipin e vet. Ekipi përbëhej nga Major Bledar Mesi, Togere Kristiana Hoxhaj dhe studentët Argyst Goxhaj, Alvaro Lutaj, Mirjan Mulgeci, Manuel Rapaj dhe Dylberg Nazarko. Ekipi i AFA-së zuri vendin e parë në renditjen ekipore, kurse si individ, Major Bledar Mesi zuri vendin e parë. Në ceremoninë përmbyllëse me këtë rast, kryetari i Bashkisë Vlorë, zoti Dritan Leli shpërndau medaljet dhe uroi fituesit dhe ekipin e AFA-së për garën e zhvilluar.



INTERVISTË ME GJENERAL BRIGADE EDITSON ZARKA

E drejta e informimit dhe sigurisë kombëtare në optikën e transparencës së publikut

INTERVISTOI:
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

Gjeneral brigade Editson Zarka përfundoi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, dhe më tej në Akademinë Ushtarake, në degën “Radiolokacion Zbulim i Largët”, duke u titulluar oficer aktiv në radhët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ai gjithashtu ndoqi studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë (Dega Juridik) në Universitetin shtetëror “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, të cilat i përfundoi në vitin 2003.

Gjeneral brigade Editson Zarka ka kryer një sërë kursesh kualifikimi si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në vitin 2000 ai kreu studimet në Kursin e Karrierës së Kapitenëve në Shkollën e Policisë Ushtarake, në Ft. Leonard Wood, në SHBA. Në vitin 2003 ai përfundoi Kursin e Menaxhimit të Mbrojtjes për Shoqëritë Demokratike, në Kolegjin Mbretëror të Shkencave Ushtarake, në Angli. Në vitin 2008 përfundoi Kursin Ekzekutiv për Studime të Avancuara të Sigurisë, në Qendrën Europiane për Studimet e Sigurisë “George Marshall”, në Gjermani. Në vitin 2009 përfundoi Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP), ndërsa në vitin 2012 përfundoi Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Tiranë. Në vitin 2013 përfundoi Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Akademinë e Forcave të Armatosura, në Tiranë. Gjeneral brigade Editson Zarka ka fituar titullin “Master Shkencor” në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes pranë Akademisë së Mbrojtjes, në Tiranë. Ndër kurset e tjera afatshkurtra janë ato që lidhen me programet e NATO/PfP-së, Armë-Kontrollit, gjuhët e huaja (anglisht, frëngjisht dhe italisht) si dhe kurse për emergjencat civile, drejtësinë ushtarake, politikat e sigurisë kombëtare, rajonale etj.

Gjeneral brigade Editson Zarka gjatë karrierës së tij ka kryer detyra të ndryshme në pozicione shtabi dhe drejtimi duke filluar nga nivele taktike e duke kaluar gradualisht në nivele operative e strategjike. Në periudhën 2000-2009 ai ka punuar në pozicione kyçe të planifikimit dhe integritimit në NATO/PfP, duke kontribuar në përgatitjen e planeve dhe programeve të bashkëpunimit tilla si Planin Individual të Partneritetit (IPP), Konceptin e Kapaciteteve Operacionale (OCC), Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit (PARP) të mbrojtjes, Planin e Veprimtimit për Anëtarësim (MAP) etj. Në vitin 2009, pas pranimit të vendit tonë në NATO, ai u emërua zëvendës-drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J-5) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të



Armatosura (SHPFA). Pas kësaj ai kreu detyra të tjera të rëndësishme si Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes (J-3/7), Drejtor i Drejtorisë së Jetësimin të Prioriteteve dhe Monitorimit, në Ministrinë e Mbrojtjes. Në periudhën korrik 2014-korrik 2017, u emërua Drejtor i Koordinimit dhe Integritimit (COI), në Drejtorinë e Partneriteteve Ushtarake (MPD), në Komandën Strategjike të Aleancës për Operacionet (SHAPE), Mons, Belgjikë. Me përfundimin e kësaj detyre, në korrik 2017 gjeneral brigade Editson Zarka u emërua Komandant i Shkollës së Trupës dhe Qendrës së Stërvitjes Individuale në Bunavi, Vlorë. Në periudhën Mars 2018-Mars 2019, ai u emërua Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J-5/8), në SHPFA. Më tej, në periudhën Prill 2019-Gusht 2020, ai kreu detyrën e zëvendëskomandantit (Komandant në detyrë) të Forcës Ajrore. Në periudhën Shtator 2020-Nëntor 2021 ai kreu një sërë detyrash të tjera si Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve

të Mbrojtjes dhe zëvendës-drejtor, në J-5/8, SHPFA; Shef i Departamentit të Liderimit dhe Shkencave Shoqërore në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, Akademia e Forcave të Armatosura; dhe Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Në datën 26 Nëntor 2021 ai u promovua në gradën “Gjeneral Brigade” nga Presidenti i Republikës.

Gjeneral brigade Editson Zarka ka qenë i përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke qenë pjesë e grupeve të punës në hartimin e dokumenteve të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, Strategjisë Ushtarake, Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave, Programit Buxhetor Afatmesëm etj. Ai ka përgatitur gjithashtu materiale referuese për tema të ndryshme që lidhen me fushën e sigurisë dhe mbrojtjes duke qenë lektor në akademi, qendra trajnimi, konferenca shkencore, seminare e workshope të ndryshme si

brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Gjeneral brigade Editson Zarka ka publikuar një sërë artikujsh në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kryesisht në fushën e planifikimit ushtarak, standardizimit, bashkëpunimit ushtarak, stërvitjet dhe trajnimin, politikave të sigurisë rajonale, kombëtare etj.

Gjeneral brigade Editson Zarka si një studiues dhe trajtues i mirë i çështjes së ‘Të drejtës së informimit publik dhe sigurisë kombëtare për një njohje më të gjerë dhe për lexuesin e gazetës “Ushtria” vjen në këtë intervistë për të na dhënë një panoramë të marrëdhënies së informimit publik dhe FA-së, si dhe çështjes së sigurisë kombëtare sidomos në këto kohë trazirash në Europë.

Gjeneral Zarka, cili ishte ndikimi i përpjekjeve postkomuniste të reformave të mbrojtjes mbi marrëdhëniet civilo-ushtarake?

Marrëdhëniet civilo-ushtarake kanë shënuar hapa pozitivë pas periudhës

postkomuniste, si rezultat i një numri reformash transformuese që kanë përfshirë institucionin e sigurisë dhe mbrojtjes. Ky proces është bërë hap pas hapi dhe ka njohur zhvillimet e veta, në periudha të ndryshme të zhvillimit të vendit dhe vetë forcave tona të armatosura. Ajo që ia vlen të përmendim është fakti i transformimit të kontrollit civil demokratik mbi forcat e armatosura, ose e thënë më gjerë, mbi forcat e sigurisë së një vendi, të cilat japin llogari dhe kontrollohen nga Parlamenti.

Cili ishte ndikimi i reformave për anëtarësimin në NATO mbi mbikëqyrjen e politikave të mbrojtjes?

Vendi ynë iu nënshtrua një serie reformash në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke marrë pjesë në programet e drejtuara nga NATO si Partneriteti për Paqe, Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit të Mbrojtjes (PARP), dhe më i rëndësishëm Plani i Anëtarësimin në NATO (MAP). Ky i fundit u shtri në pesë fusha kryesore, përfshirë mekanizmat e mbikëqyrjes të sektorit të sigurisë, politikave të mbrojtjes etj. Ajo që është e rëndësishme të nënvizohet është fakti se politikat e mbrojtjes të vendit tonë u bënë në përputhje me politikat e NATO-s, duke sinkronizuar punën në drejtim të legjislacionit, standardizimit, objektivave afatmesme e afatgjatë, si dhe pjesëmarrjes në forumet kryesore të NATO-s. Të gjitha këto patën impakte të drejtpërdrejta në vendin tonë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat tona të Armatosura.

Cilat janë sfidat aktuale të mbikëqyrjes së politikave të mbrojtjes?

Politikat e mbrojtjes shprehin në thelb politikën shtetërore të një vendi për arritjen e objektivave të caktuara. Sfidat aktuale të saj janë përballimi i kërcënimeve dhe rreziqeve të reja që i kanosen komunitetit ndërkombëtar, sigurisë euro-atlantike, sigurisë rajonale, kombëtare e më gjerë. Konflikti i armatosur në Ukrainë ka rritur ndjeshëm impaktin në Aleancën e NATO-s, Bashkimin Europian dhe të gjitha vendet, të cilat janë ndikuar në një formë ose një tjetër nga ky konflikt. Mbikëqyrja e politikave të mbrojtjes bëhet në përputhje me mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur.

Integritimi i konceptit të kontrollit demokratik në planet e reformave të mbrojtjes?

Mendoj që ky koncept ka qenë i shkruar në planet e reformave të mbrojtjes, për vet dimensionin që paraqet si koncept. Pavarësisht kësaj, është bërë një punë e mirë ndër vite për njohjen e konceptit, duke shfrytëzuar eksperiencën më të mirë të vendeve perëndimore, si

dhe atë të institucioneve arsimore apo qendrave të ndryshme që e trajtojnë më gjerësisht këtë aspekt. Këto reforma i shërbejnë demokratizimit të forcave të armatosura, përshtatjes së tyre me mjedisin e sigurisë, si dhe pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare, duke rritur ndërveprimin dhe standardizimin me forcat aleate.

Kontrolli demokratik dhe transformimi i Forcave të Armatosura?

Siç e përmendëm edhe më parë, kontrolli demokratik ushtrohet kryesisht nga organet e zgjedhura siç është Parlamenti me komisionet e tij, sidomos Komisioni i Sigurisë, Komisioni i Politikës së Jashtme, apo komisionet përkatëse që kanë të bëjnë me aspektet e buxhetit të mbrojtjes, planeve të modernizimit, pjesëmarrjes në operacionet ndërkombëtare etj. Në republikat parlamentare, parlamenti është sovran dhe i kërkon llogari ekzekutivit për hartimin, zbatimin dhe rishikimin e politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes. Kontrolli demokratik dhe transformimi i forcave të armatosura shkojnë dora dorës në shoqëritë demokratike. Transformimi kryhet si proces i domosdoshëm për të pasur struktura sa më operacionale dhe për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë. Hapat e këtij transformimi duhet të kryhen nën mbikëqyrjen dhe kontrollin demokratik të tyre.

Cili është roli i shoqërisë civile dhe i institucioneve të mbrojtjes?

Shoqëria civile luan një rol të veçantë në shoqëritë demokratike, institucionet e shtetit përfshirë atë të mbrojtjes. Aktivitetet që organizon kjo shoqëri ndihmojnë në rritjen e transparencës, në proceset e konsultimit publik, si edhe në të drejtën e informacionit për aspekte të veçanta, ku përfshihet sfera e veprimtarisë së institucionit të mbrojtjes. Institucionet e mbrojtjes kanë rol kryesor zbatimin e kushtetutës për mbrojtjen e integritetit territorial, pavarësisht së vendit, si dhe përmbushjen e detyrimeve kombëtare e ndërkombëtare, si pjesë e aleancës Euro-Atlantike, apo detyrimet për zbatimin e marrëveshjeve e konventave ku vendi ynë bënë pjesë.

Cilat janë zhvillimet e kohëve të fundit në mjedisin e sigurisë?

Mjedisi i sigurisë karakterizohet nga të panjohurat dhe zhvillimet krejtësisht të paparashikueshme, daljen e autorëve të rinj, të cilët, si kurrë ndonjëherë më parë, arrijnë të krijojnë probleme apo rreziqe për sigurinë kombëtare, rajonale dhe globale. Krimi organizuar, terrorizmi, përhapja e armëve të dëmtimit në masë, trafiket e paligjshme, ndryshimet klimaterike, krimi kibernetik, janë disa nga kërcënimet dhe rreziqet që kërcënojnë sigurinë kombëtare. Mjedisi i sigurisë është shumë kompleks, sidomos në ditët që po kalojmë sot me ngjarjet në Ukrainë nga pushtimi rus. Ky konflikt ka ndikuar drejtpërsëdrejti në vendimarrjet e institucioneve ndërkombëtare të sigurisë, si dhe në të gjitha vendet, të cilat preken si ekonomikisht, po ashtu edhe në fusha të tjera përfshirë fushën e mbrojtjes. Në këtë kuadër lind si domosdoshmëri rishikimi i mbrojtjes, për t'i bërë ballë kërcënimeve të reja, për modernizimin e forcave dhe blerjen e armëve dhe sistemeve bashkëkohore.

Cilat janë rreziqet dhe kundërveprimet e reja?

Rreziqet e sigurisë janë ato tradicionale dhe jo-tradicionale, përfshirë sfidat e reja në fushën kibernetike, gjeo-hapësinore e më gjerë. Zhvillimi i teknologjisë ndikon drejtpërdrejtë edhe në zhvillimin e metodave të reja në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Vendet përgatisin strategji dhe plane periodike të cilat i evidentojnë këto kërcënime dhe rreziqe, si dhe marrin masa për reagimin dhe kundërveprimin ndaj tyre, në mëvetësi ose në përbërje të organizatave rajonale, apo koalicioneve të vullnetit të përbashkët, në përputhje me ligjin dhe të drejtën ndërkombëtare. Ndryshimi i vazhdueshëm i këtij mjedisi kërkon ndryshimin e strategjive dhe planeve të mbrojtjes për t'iu përgjigjur më mirë sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve. Vend të rëndësishëm zë bashkëpunimi reciprok, krijimi i kapaciteteve të përbashkëta për pjesëmarrje në operacione luftarake dhe jo-luftarake, përfshirë emergjencat civile dhe katastrofat natyrore.

A është e nevojshme mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë?

Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë është një kërkesë shumë e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e këtij sektori, përfshirë institucionin e mbrojtjes. Kjo është një kërkesë kushtetuese në shtetet demokratike, e cila kontrollon veprimtarinë e strukturave të sigurisë, siguron transparencë më të gjerë për publikun, kontrollon shpenzimet që bëhen në këto organe, në përputhje me ligjin, projektet e miratuar, sidomos në drejtim të shpenzimeve për blerjet ushtarake e me gjerë.

Cilat janë parimet kryesore të qe-

sigurisë, transparencën, llogaridhënien, informimin publik, përmbushjen e detyrimeve kushtetuese etj., pjesëmarrja në organizatat ndërkombëtare, ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e parimeve në fushën e sigurisë. Ndër to mund të përmendim parimet për përdorimin e forcës, zgjidhjen paqësore të konflikteve, ruajtja e integritetit territorial, mosdërhyrjen në punët e brendshme të një shteti tjetër, respektimin e të drejtave të njeriut, bashkëpunimin midis shteteve, si dhe përmbushjen e detyrimeve të së drejtës ndërkombëtare.

Si lidhet shoqëria civile me fushën e sigurisë ose si mund t'i komunikohen publikut çështjet e sigurisë?

Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në fushën e sigurisë. Ajo adreson problematikat të cilat janë në interes të publikut të gjerë dhe organet e sigurisë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë. Roli dhe veprimtaria e saj është e ndryshme dhe e larmishme. Shoqëria civile mund të përpiqet aktivisht dhe të japë ndikimin e vet tek vendimarrjet dhe politikën në fushën e sigurisë. Komunikimi me publikun bëhet me një serë mekanizmesh dhe mjeteve. Konsultimi publik, debatet parlamentare, informimi pro-aktiv nëpërmjet faqeve zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturave të vartësisë, adresimi i kërkesave nëpërmjet portaleve të ndryshme të informimit publik janë disa nga mekanizmat e komunikimit me publikun e gjerë.

Cili është roli i grave në fushën e sigurisë?

Barazia gjinore është një shqetësim publik i cili ka marrë një vëmendje të madhe ndërkombëtare në dekadat e

paqeruajtëse, operacionet humanitare, rindërtimin dhe rehabilitimin, si dhe për çarmatimin, çmobilizimin dhe integrimin. Vendi ynë ka bërë hapa konkretë në këtë drejtim. Zbatimi i rezolutës së 1325 i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara kërkon, krahas të tjerave, edhe përfaqësimin e tyre në pozicione kyçe në strukturat e MM dhe FARSH, përfshirë pjesëmarrjen e tyre në operacionet ndërkombëtare. Në këtë kategori futet përfaqësimi i tyre në postet jashtë vendit, ku vendi ynë është pjesë e strukturave të ndryshme të sigurisë dhe mbrojtjes. Rritja e rolit të grave në proceset e vendimarrjes së politikës së sigurisë dhe zbatimin e saj, ka sjellë hapa shumë pozitive në këtë drejtim.

Cila është etika profesionale në këtë fushë?

Etika profesionale është një komponent i rëndësishëm në fushën e sigurisë. Ajo është bërë pjesë e veprimtarisë së forcave të sigurisë. Vlerat morale, besnikëria, detyra, respekti, kuraja profesionale, besimi, rritja e profesionalizmit, dedikimi, barazia, fryma e bashkëpunimit janë elementë përbërës të etikës profesionale të strukturave të sigurisë.

A mund të krijojnë ushtarakët organizata ushtarake?

Kjo fushë është diskutuar edhe më herët, duke pasur parasysh disa vende perëndimore, të cilat kanë organizata të tilla dhe që i shërbejnë më mirë komunitetit ushtarak për të adresuar çështje të ndryshme. Një përvojë e mirë është edhe ajo e strukturave të ministrisë së brendshme që kanë një organizatë të tillë. Liria për t'u organizuar në shoqata ushtarake është një e drejtë kushtetuese,

të bëhet brenda kontekstit kushtetues e ligjor, duke marrë përvojat më të mira të vendeve demokratike.

Si mund të kontrollohet fusha e sigurisë?

Mekanizmat e kontrollit në fushën e sigurisë janë të shumta, të cilat zbatohen edhe në vendin tonë. Ato përfshijnë fushën e llogaridhënies para parlamentit, kontrollin e buxhetit, prokurimet e mëdha, pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare, projektet në fushën e infrastrukturës ushtarake etj. Kontrolli mund të jetë i jashtëm, ose i brendshëm. Në kontrollin e jashtëm futet kontrolli parlamentar, kontrolli i lartë i shtetit, inspektimet e ndryshme, avokati i popullit, kontrolli në kuadër të pjesëmarrjes në organizatat ndërkombëtare për realizimin e objektivave të përbashkëta etj. Ndërsa kontrolli i brendshëm përfshin inspektimet dhe verifikimet e ndryshme, auditet, kontrolli për fusha dhe aspekte të veçanta, të cilat bëhen të strukturuar me plane konkrete, në përfundim të të cilave përgatiten raporte për pasqyrimin e gjendjes dhe rekomandimet për përmirësimin e tyre.

Si është rregulluar mobilizimi ushtarak dhe shërbimi alternativ në vende të ndryshme?

Mobilizimi ushtarak dhe shërbimi alternativ në vende të ndryshme është i ndryshëm. Pikë së pari kjo varet nga forma e qeverisjes në këto vende, shtete demokratike, apo autokratike. Edhe vendi ynë kaloi nga një sistem totalitar para viteve '90 në një vend demokratik pas këtyre viteve.

Mobilizimi ushtarak është i sanksionuar me ligj dhe bëhet në kushte të caktuara të gjendjes së jashtëzakonshme, apo të luftës. Ndërsa shërbimi alternativ është një mundësi që u jepet shtetasve të kryejnë shërbimin ushtarak në kushte më lehtësuese dhe jo drejtpërdrejt me armë. Shumica e vendeve përfshijnë në ligj të drejtën e qytetarëve për të mos pranuar të mbajnë armë, domethënë kundërshtimin e ndërgjegjshëm dhe mundësinë e kryerjes së shërbimit alternativ.

Këtu futen puna në institucionet e ndihmës shoqërore siç janë spitalet, infirmieritë, institucionet për njerëzit me aftësi të kufizuara etj., dhe nganjëherë në organizatat jo qeveritare, apo ato ndër-qeveritare etj.

Cilat rrethana e justifikojnë fshehtësinë?

Transparenca dhe informimi i publikut mbeten parime bazë të punës së strukturave të sigurisë.

Në të njëjtën kohë mbrojtja e të drejtave të njeriut, ruajtja e privatësisë, ruajtja e raportit midis sigurisë publike dhe sigurisë së individit janë elementë të rëndësishëm të punës së forcave të sigurisë.

Fshehtësia është e lidhur drejtpërsëdrejti me sigurinë e vendit dhe sigurinë publike.

Në demokraci, shërbimet e fshehta të informacionit kërkohen të jenë efektive, asnjëherë, t'i përmbahen etikës profesionale, dhe të veprojnë brenda mandatit të tyre të ligjshëm. Vetëm në këto rrethana ajo mund të justifikohet në veprimet e ndërmarra në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



verisjes demokratike në fushën e sigurisë?

Politika e sigurisë kombëtare parashtron, para së gjithash, qëndrimin e qeverisë ndaj sigurisë dhe mënyrën si mendohet që të arrihet kjo siguri. Parimet kryesore të qeverisjes lidhen me kontrollin civil demokratik në fushën e

fundit. Gratë përbëjnë gati 50% të popullsisë botërore, kështu që ato kanë dhe duhet të kenë të drejta të barabarta me burrat dhe kanë shumë për të dhënë që të kontribuojnë për zgjidhjen e çështjeve të sigurisë. Roli i grave është i qenësishëm në fushën e sigurisë, pjesëmarrjen e tyre në proceset e paqes, operacionet

e cila ndihmon konsolidimin e vlerave demokratike edhe në radhët e Forcave të Armatosura. Duke respektuar dhe mbrojtur sa më shumë të drejtat dhe liritë themelore të ushtarakëve aq më shumë ndikojmë në rritjen e dinjitetit dhe përmbushjen e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura. Krijimi kuptohet që duhet

Aleatët i përgjigjen së bashku luftës brutale të Rosisë kundër Ukrainës

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe kancelari gjerman diskutojnë përgatitjet e Samitit të Madridit

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dhe kancelari gjerman Olaf Scholz diskutuan përgatitjet për Samitin e ardhshëm të Madridit nëpërmjet një telekonference, më 9 qershor 2022.

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi kancelarin Scholz për angazhimin e tij të fortë personal ndaj NATO-s dhe për kontributet e rëndësishme të Gjermanisë në NATO, të cilat janë edhe më të rëndësishme, pasi aleatët vazhdojnë t'i përgjigjen së bashku luftës brutale dhe të paligjshme të Rosisë kundër Ukrainës. Ai lavdëroi mbështetjen e konsiderueshme të Gjermanisë për sovranitetin e Ukrainës,



me ndihmën ushtarake, ekonomike dhe humanitare. Në Samitin e Madridit, udhëheqësit e NATO-s do të diskutojnë mbështetjen e qëndrueshme për Ukrai-

nën për një afat më të gjatë. Gjermania kryeson grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s në Lituani, i cili ndihmon në mbrojtjen e paqes dhe pengimin e



agresionit në rajonin e Detit Baltik. Z. Stoltenberg përgëzoi kancelarin Scholz për njoftimin e tij të fundit se Gjermania është e gatshme të forcojë angazhimin e

saj në Lituani dhe ta zhvillojë atë drejt një brigade të fuqishme të gatishmërisë luftarake.

Sekretari i Përgjithshëm dhe kancelari Scholz diskutuan rëndësinë e Konceptit të ardhshëm Strategjik të NATO-s dhe aplikimet historike të Finlandës dhe Suedisë për t'u bashkuar me NATO-n.

Sekretari i Përgjithshëm foli veçmas me ministrin gjerman të Mbrojtjes Christine Lambrecht përmes video-telekonferencës mbi përgatitjet për Samitin e Madridit dhe takimin e javës së ardhshme të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s në Bruksel.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s trajton parandalimin dhe mbrojtjen me kryeministrat baltikë

Krahu Lindor i Aleancës

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në një konferencë telefonike me kryeministren e Estonisë Kaja Kallas, kryeministrin letonez Arturs Krišjānis Kariņš dhe kryeministren e Lituaniës Ingrida Šimonytė, më 8 qershor 2022. Fokusi i diskutimit të Sekretarit të Përgjithshëm me kryeministrat ishte mbi forcimin e ndjeshëm të mbrojtjes dhe qëndrimin parandalues të NATO-s në pjesën lindore të Aleancës. Që nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia, NATO është përgjigjur shpejt, duke rritur gatishmërinë e forcave të Aleancës, duke vendosur njësi të Forcës së Reagimit të NATO-s dhe duke dyfishuar numrin e grupeve luftarake shumëkombëshe nga katër në tetë. Tani ka 40 000 trupa nën komandën e drejtpërdrejtë të NATO-s, kryesisht në pjesën lindore të Aleancës, duke përfshirë Estoninë, Letoninë dhe Lituani. Në Samitin e NATO-s në Madrid në fund të këtij muaji, udhëheqësit do të përshtatin qëndrimin e Aleancës për një afat më të gjatë, për të pasqyruar realitetin e ri të sigurisë.

Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi kontributet e vazhdueshme të vendeve baltike në Aleancë, përfshirë angazhimet kombëtare për të kapërcyer 2.5% të PBB-së së tyre për shpenzimet e mbrojtjes. Ai gjithashtu përshtet mbështetjen e tyre të fortë për Ukrainën në përgjigje të pushtimit të Rosisë, përfshirë ndihmën e konsiderueshme ushtarake dhe humanitare.

Prania ushtarake e NATO-s në lindje të Aleancës

Komponent i rëndësishëm i qëndrimit parandalues dhe mbrojtës të NATO-s është prania ushtarake në pjesën lindore të territorit të Aleancës. Në vitet e fundit, aleatët kanë rritur praninë përpara, të NATO-s, duke krijuar grupe betejë shumëkombëshe në Bullgari, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Rumania dhe Sllovakia. Ata kanë dërguar gjithashtu më shumë anije, aeroplanë dhe trupa në krahun lindor të NATO-s, nga Deti Baltik në veri deri në Detin e Zi në jug. "Këto veprime demonstron solidaritetin, vendosmërinë dhe aftësinë e aleatëve për të mbrojtur territorin dhe popullsinë e Aleancës. Përpara aneksimit ilegal dhe të paligjshëm të Krimesë nga Rusia në vitin 2014, NATO nuk kishte plane për të vendosur trupa luftarake në pjesën lindore të Aleancës. E ndërsa në Samitin e NATO-s, në vitin 2016 në Varshavë, në përgjigje të paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë në rritje përgjatë periferisë së NATO-s, kërret e shteteve dhe qeverive aleate ranë dakord të rrisin praninë e zgjeruar përpara të NATO-s në lindje dhe juglindje të Aleancës. Kjo prani e zgjeruar përpara u krijua për herë të parë në vitin 2017, me krijimin e katër grupeve luftarake shumëkombëshe të madhësisë së batalionit në Estoni, Letoni, Lituani dhe Poloni. Këto grupe betejë, të udhëhequra nga Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara



përkatësisht, janë forca të fuqishme dhe të gatshme për luftim. Ato demonstron forcën e lidhjes transatlantike dhe bëjnë të qartë se një sulm ndaj një aleati do të konsiderohej një sulm ndaj të gjithë Aleancës. Pas pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022, aleatët ranë dakord të krijojnë katër grupe luftarake shumëkombëshe në Bullgari, Hungari, Rumania dhe Sllovakia. Kjo e çon numrin e përgjithshëm të grupeve luftarake shumëkombëshe në tetë, duke u shtirë në të gjithë krahun lindor të NATO-s, nga Deti Baltik në veri deri në Detin e Zi në jug. Shumë aktivitete të ndërmarra nga Aleatët në nivel kombëtar, megjithëse nuk janë formalisht pjesë e pranisë përpara të NATO-s, gjithashtu kontribuojnë në rritjen e aktivitetit aleat në pjesën lindore të Aleancës. Në përgjigje të pushtimit rus të Ukrainës, aleatët kanë dërguar anije, avionë dhe trupa shtesë në territorin e NATO-s në Europën Lindore dhe Juglindore, duke përforcuar më tej qëndrimin parandalues dhe mbrojtës të Aleancës.

Prezenca e NATO-s Përpara

Prania ushtarake e NATO-s në pjesën lindore të Aleancës është një pjesë kyçe e qëndrimit të fortë për parandalimin dhe mbrojtjen së NATO-s, e cila është përmirësuar vitet e fundit për të pasqyruar realitetin e ri të sigurisë në zonën euro-atlantike. Aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia, agresioni i vazhdueshëm kundër fqinjëve të saj dhe pushtimi i plotë i Ukrainës, kanë ndryshuar rëndësinë mjedisin e sigurisë në Europë dhe NATO është përgjigjur duke forcuar ndjeshëm gatishmërinë e saj për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët. Prania përpara e forcave aleate është mbrojtëse, proporcionale, transparente dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet ndërkombëtare të Aleancës. Ajo përfaqëson një angazhim të rëndësishëm nga aleatët dhe është një kujtesë e prekshe se një sulm ndaj një vendi anëtar të NATO-s është një sulm ndaj të gjithëve. Prania e përparme e NATO-s përbëhet

Fushimin e vërtetë veror shkolla e oficerëve e ka ndërtuar gjatë viteve 1959-63 në bregdet, pranë fshatit Karpen të Kavajës dhe kripores. Shkolla ka filluar të dalë në fushime dimërore që nga viti 1950. Dalja e shkollës në këto fushime është bërë çdo vit dhe brenda tremujorit të parë të vitit. Vendet kryesore ku janë ngritur fushimet dimërore kanë qenë në malin e Dajtit, malin e Fekenit, Malin me Gropa, Bizë, etj. Shkolla nuk ka pasur fushime dimërore të parapërgatitura. Nododhesh në një stërvitje dy ditore në kodrat lindore të Tiranës, kur oficeri i rojës me anë të korrierit më lajmëroi se në orën 12.00 duhej të paraqitesha në zyrën e Hysni Kapos. "Partia me MMP kanë menduar të ngarkojnë me detyrën e komandantit të Shkollës së Bashkuar". Ky ishte njoftimi dhe emërimi im i ri.

Punoj në Institutin e Shkencave Ushtarake (Shkurt 1972-janar 1974)

Në fillim të vitit 1972, sekretari i ministrit të MMP më lajmëroi që të paraqitem te ministri. Ministri Beqir Balluku më priti mirë, u ngrit në këmbë kur hyra në zyrën e tij dhe më ftoi të ulesha pranë tij. Pasi më bëri disa lëvdata për punën time në shkollën e oficerëve, më tha se kishin menduar të më transferonin në Institutin e Shkencave Ushtarake.

Në ISU gjeta shumë shokë të njohur me të cilët kisha punuar edhe në ShBo ose që i njihja prej kohësh, si: Ernest Jakova, Mina Mishaxhiu, Haki Sinoimeri, Sotir Paluka, Rasisim Bazo, Muharrem Qenaj, Petrit Goxhi, Mujo Sokoli, Spiro Shalësi, Sadik Bekteshi, etj. Të gjithë ishin oficerë të përgatitur, të aftë e punëtorë. Në muajin shkurt të vitit 1974 të gjithë kuadrot e ISU u thirrën në MMP ku shefi i shtabit të përgjithshëm Veli Llakaj na lexoi vendimin për daljen në pension dhe na pyeti nëse kishim ndonjë gjë për të thënë. Nuk foli askush. Kaq ishte e gjithë historia e daljes sonë në pension. Pas dy muajsh që kisha dalë në pension, organizata e pensionistëve të lagjes nr. 3, ku ishte sekretar Vaskë Nasi (njeri i mirë, i urtë e i sjellshëm), më zgjodhi si propagandist të saj, kurse pas disa muajsh në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve, më zgjodhën zëvendëssekretar të byrosë së partisë së lagjes, detyrë që e kam mbajtur deri në vitin 1989, kur u shkëput fare ato...

“Një komb është një familje e madhe që ka nevojë për të gjithë të mirat e së voglës: shkuarja e mirë, harmonia, bashkëpunimi këtu janë shumë më të nevojshme se te familja. Për lumturinë e një kombi duhet që njeriu të ketë këtë virtut, që në frëngjisht i thonë altruizëm. Altruizmi është vetia fare kundër egoizmit: egoizmi na urdhëron që të mundohemi vetëm për veten tonë, të bëjm’ atë që na do qejfi, t’i bëjmë dëm tjetrit për të mirën tonë”.



Altruizmi i humanëve, ndjesi apo vlerë

SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

Në një botë të dominuar nga përplasjet ideologjike dhe rivalitetet kulturore, harrojmë se altruizmi nuk është një dobësi, por një domosdoshmëri evolucionare. Na e mësuam paraardhësit e kafshëve.

Altruizmi është devocioni ndaj nevojave të tjerëve duke flijuar apo hequr dorë nga interesi dhe e mira vetjake. Megjithatë, shpesh altruizmi mund edhe të jetë një sjellje në ndjekje të interesit personal, vetëm se në këtë rast kënaqësia personale fitohet duke ndihmuar të tjerët në vend të të ndihmuarit ekskluzivisht veten.

“M’e madhe e uratave, që mund t’i bëhet një shtëpie, një familjeje, është të shkuarit mirë: po s’pati një shkuarje të mirë, një dashuri rreth vatrës, atë shtëpi e merr lumi. Grindja dhe zihja e shuajnë shumë më shpejt se zjarri e se vdekja. Për të pasur rrojtjen e ëmbël në gjë të një familjeje, duhet që çdo njeri të bëjë pak therror nga dëshirat e tij, të heqë pak dorë nga egoizmi, të ndjejë fajet e tjetrit e të kuptojë fajet e tij. Një komb është një familje e madhe që ka nevojë për të gjithë të mirat e së voglës: shkuarja e mirë, harmonia, bashkëpunimi këtu janë shumë më të nevojshme se te familja. Për lumturinë e një kombi duhet që njeriu të ketë këtë virtut, që në frëngjisht i thonë altruizëm. Altruizmi është vetia fare kundër egoizmit: egoizmi na urdhëron që të mundohemi vetëm për veten tonë, të bëjm’ atë që na do qejfi, t’i bëjmë dëm tjetrit për të mirën tonë. Po altruizmi na këshillon që më parë të mendojmë tjetrin, të shikojmë të mirën e tij, të ruajmë të drejtat e shokut tonë, me një fjalë, altruizmi na thotë që çdo punë ta gjykojmë pas interesit të përgjithshëm dhe jo vetëm pas interesit tonë. Altruizmi është ajo lëndë, mund të themi, që lidh njerëzit e një kombi, gëlqerja që lidh gurët e një muri” (Mid’hat Abdyl Frashëri).

Cfarë është altruizmi?

Altruizmi është një aktivitet njerëzor që synon kujdesin për një person tjetër, mirëqenien e tij dhe kënaqësinë e interesave të tij.

Një altruist është një person, konceptet dhe sjellja morale e të cilit bazohen në solidaritetin dhe shqetësimin, para së gjithash, për njerëzit e tjerë, për mirëqenien e tyre, respektimin e dëshirave të tyre dhe dhënien e ndihmës ndaj tyre.

Një individ mund të quhet altruist kur, në ndërveprimin e tij shoqëror me të tjerët, nuk ka mendime egoiste për përfitimim e tij.

Ka 2 pika shumë të rëndësishme: nëse një person është vërtet i paiteruar dhe pretendon të drejtën për t’u quajtur altruist, atëherë ai duhet të jetë altruist deri në fund: të ndihmojë dhe të kujdeset jo vetëm për të dashurit, të afërmit dhe miqtë e tij (që është detyrë e tij natyrore), por edhe të ofrojë ndihmë plotësisht për të huajt, pavarësisht nga gjinia, Pika e dytë e rëndësishme: të ndihmohet pa shpresën e mirënjohjes dhe reciprocitetit. Ky është ndryshimi themelor midis një altruisti dhe një egoisti: një person altruist, ndërsa ofron ndihmë, nuk ka nevojë dhe nuk pret lëvdata, mirënjohje, favore reciproke në këmbim, nuk lejon as mendimin se tani i detyrohet diçka. Ai është i neveritur nga vetë ideja të se me ndihmën e tij vendos një person në një pozitë të varur nga vetja dhe mund të presë ndihmë ose shërbime në këmbim, në përputhje me përpjekjet dhe mjetet e shpenzuara! Jo, një altruist i vërtetë ndihmon pa interes, ky është gëzimi dhe qëllimi i tij kryesor. Ai nuk i referohet veprimeve të tij si një “investim” në të ardhmen, nuk do të thotë se do t’i kthehet, ai thjesht jep pa prituri asgjë në këmbim.

Disa nëna i japin fëmijës gjithçka që i nevojitet: edukim, aktivitete zhvillimore shtesë që zbulojnë talentet e fëmijës, pikërisht atë që i pëlqen VETË, dhe jo prindërve të tij; lodra, rroba, udhëtime, udhëtime në kopshtin zoologjik dhe atraksione, kënaqja me ëmbëlsirat gjatë fundjavave dhe kontrolli



i butë, pa vëmendje.

Në të njëjtën kohë, ata nuk presin që fëmija, pasi është bërë i rritur, do t’u japë para për të gjitha këto argëtime? Ose që është i detyruar të jetë i lidhur me nënën e tij gjatë gjithë jetës, të mos ketë jetë personale, siç nuk e bëri ajo, duke qenë i zënë me një foshnjë; shpenzoni të gjitha paratë dhe kohën tuaj për të? Jo, nëna të tilla nuk e presin këtë, ato thjesht e japin atë, sepse ato e duan dhe urojnë lumturinë e foshnjës së tyre, dhe më pas ato kurrë nuk i qortojnë fëmijët e tyre për paratë dhe përpjekjet e shpenzuara.

Ka nëna të tjera. Komplet i argëtimit është i njëjtë, por më së shpeshti imponohet gjithçka: aktivitete shtesë, argëtim, veshje, jo atë që dëshiron fëmija, por atë që prindërit zgjedhin për të dhe e konsiderojnë më të mirën dhe të nevojshmen për të. Jo, ndoshta në një moshë të re vetë fëmija nuk është në gjendje të zgjedhë siç duhet rrobat dhe ushqimin për vete (kujtoni se si fëmijët i duan tatetat e skuqura, kokoshkat, ëmbëlsirat në sasi të mëdha dhe janë gati të hanë Coca-Cola dhe akullore për javë të tëra), por çështja është ndryshe: prindërit e trajtojnë fëmijën e tyre si një “investim” fitimprurës.

Kur të rritet, atij i drejtohen frazat:

- “Nuk të rrita për këtë!”
- “Ti duhet të kujdesesh për mua!”
- “Më ke zhgënjyer, kam investuar shumë te ti, edhe ti...”
- “Unë i kalova vitet e mia të rinisë për ju, dhe si më paguani për kujdesin?”

Llojet e altruizmit

Ai konsiston në nevojat e pavetëdijshme të çdo prindi për t’u kujdesur për fëmijën e tij. Babai dhe nëna shpesh detyrohen të sakrifikojnë veten për hir të lumturisë dhe mirëqenies së foshnjës në të ardhmen. Në dashuri e tyre nuk do të ishte vetëmohuese, nuk mund të ishte për altruizëm. Dashuria prindërore nuk kufizohet me asgjë: nuk gjykon, nuk kërkon përfitimim e vet, nuk e detyron të bëhet “debitor”. Ky lloj altruizmi merret si i mirëqenë nga shumë njerëz, dhe për këtë arsye nuk konsiderohet aspak diçka e pazakontë.

Altruizmi moral

Këtu po flasim për akte të tilla shumë morale që ndryshojnë vetëdijen e një personi: ato zgjohen

në të mirënjohje, çiltërsi, dëshirë për të qenë të dobishëm, për të mos u varur nga disponimi i dikujt. Ideat morale lidhen fort me qëndrimet shoqërore dhe shërbimin ndaj njerëzve. Ky lloj ndihme vetëmohuese bazohet në besimet shoqërore. Është institucioni shoqëror që ndonjëherë i dikton individit se si duhet të jetojë, ku t’i drejtojnë përpjekjet e tij individuale.

Altruizmi empatik

Ky lloj manifestimi fisnik i cilësive më të mira të karakterit të një personi bazohet në nevojën shpirtërore për t’u kuptuar dhe dëgjuar. Vetëm ai që mundet t’u dëgjojë dhe mbështesë në kohë të vështira, mund të pretendojë se quhet miku më i mirë dhe shoku fisnik. Ky lloj përkushtimi holistik i vetes ndaj një personi tjetër lejon që shpirti të hapet me të vërtetë, të arrijë mirëkuptim të plotë të ndërsjellë me njerëz të afërt dhe të dashur.

Shembuj të altruizmit

Pa kërkuar diçka në këmbim, është një shembull kryesor i altruizmit. Një altruist i vërtetë, duke u dhënë kujdes dhe ngrohtësi të tjerëve, nuk mendon kurrë se çfarë përfitimi do të ketë ai personalisht nga ky veprim. Një person i tillë është i gatshëm të ndajë pa interes mendimet, aspiratat, disponimin dhe mundësitë e tij me ata që janë afër. Të mirat materiale për të, si rregull, kanë pak rëndësi. Përkushtim vetëmohues e bën atë të dallueshëm në sytë e shoqërisë. Një altruist nuk kërkon kurrë asgjë në këmbim. Ai është i gatshëm të ndihmojë me vetëmohim ata që kanë nevojë, të dëgjojë dëshirat e njerëzve të tjerë. Në të njëjtën kohë, një person i tillë kujton veten dhe nevojat e tij, si rregull, të fundit. Ai shpesh anashkalohet kur bëhet fjalë për promovime, para ose mirënjohje.

Motivi i aktivitetit

Një altruist bën diçka për t’i bërë të tjerët të ndihen mirë, ndërsa një egoist bën diçka për ta bërë veten të ndihet mirë.

Nevoja për “shpërblim” për veprat. Një altruist nuk pret shpërblime për aktivitetet e tij (monetare ose verbale), motivet e tij janë shumë më të larta. Egoisti, nga ana tjetër, e konsideron krejt të natyrshme që veprat e tij të mira të vihen

re, të “mbahen në llogari”, të kujtohen dhe të përgjigjen me një favor për një favor.

Nevoja për famë, lavdërim dhe njohje. Një altruist nuk ka nevojë për dafina, lavdërime, vëmendje dhe lavdi. Egoistët, nga ana tjetër, e duan kur veprimet e tyre vihen re, lavdërohen dhe përmenden si shembull, si “njerëzit më vetëmohues në botë”. Ironia e situatës është, natyrisht, e dukshme.

Marrim rastin e mëllenjave. Kur një skifter i afrohet tufës, mëllenjat lëshojnë një fishkëllimë veçanërisht të lartë për të paralajmëruar shokët e tyre. Ky alarm bën që zogjtë e tjerë të shpëtojnë menjëherë, por kjo i bën zogjtë që i lëshojnë ato, lehtësisht të lokalizueshëm nga skifterët, të cilët kanë tendencën të mbështeten në këto sinjale. Altruizmi nuk është gjë tjetër veçse ndjenjë, pak a shumë e vetëdijshme, e reciprocitetit. Kjo është shumë e zakonshme në të ashtuquajturit gjitarë të sipërm, të cilët e kanë trurin shumë të ngjashëm me tonin: si elefantët, delfinët, qentë dhe natyrisht majmunët. Tek këta të fundit, reciprociteti mund të vërehet në një situatë tipike: ajo e trajtimit të ndërsjellë për të eliminuar parazitët nga vendet e pakëndshme. Arsyetimi është thjesht “nëse më pastron kurrizin, më pas do të kujdesem unë për tënden”. Por nuk bëhet fjalë vetëm për një ndjesi instinktive. Prova në fakt është se majmunët kërkojnë partnerin më të besueshëm, atë që ofron garanci më të mëdha, për të kthyer favorin. Kjo ndjenjë reciprociteti është e pranishme tek të gjithë njerëzit në planet, pavarësisht nga traditat e tyre kulturore, aq shumë sa që mund të konsiderohet një ndjenjë universale.

Cilësitë e një personi altruist:

- Jo-egoizmi
- Mirësia
- Bujaria
- Mëshira
- Dashuria për njerëzit
- Respekti për të tjerët dhe sakrifica
- Fisnikëria

Jo të gjithë heronjtë, janë të rinj e të bukur. Përkundrazi shpesh kanë fytyra të zakonshme dhe histori banale pas vetes. Njerëz normalë, me të cilët ecim krah për krah çdo ditë dhe nuk e dimë se brenda tyre fshihet shpirti altruist deri në vetëflijmë siç është dhe rasti i 32-vjeçarit Arjan Sala “Dëshmor i Atdheut”, i cili humbi jetën në përpjekje për të shpëtuar kolegët e tij, gjatë rënies së zjarrit në kompaninë ku ata prej vitesh punonin. Shpesh aktet heroike nuk kanë fund të lumtur siç ishte dhe Arjani, djali trim që la pas fëmijën e tij ende bonjak.

Individë që kanë vënë në rrezik vetveten, për të shpëtuar të panjohurit.

Si kanë mundur?

Çfarë kanë të veçantë këta “heronj të rastit?” Aktet heroike janë gjithnjë mbresëlënëse, por në realitetin e sotëm këto veprime vijnë në një kohë kur çdonjëri po rëndë drejt diçkaje që nuk ka në fokus kujdesin për tjetrin. Sigurisht reagime të tilla deri në vetëflijmë, nuk janë të rastësishme. Çdokush që mund të jetë ndalur për ta menduar këtë koncept e ka kuptuar se ai është edukuar për të qenë i tillë...

Arjan Sala është heroi për të cilin kemi nevojë. Kemi nevojë të ndriçojmë udhëtimin tonë të përgjegjësive në shoqëri, në punë. Ai lindi dhe u rrit në periferi të Tiranës për t’u bërë publik përmes këtij akti, që tejkalon përmasat kombëtare. Sakrificat e tij deri në vetëflijmë e bëjnë atë një hero global të shoqërisë së sotme.

Trashëgimia jonë kulturore, është shumë e pasur në krahasim me përmasat gjeografike të vendit tonë, dhe është një dëshmi e qartë e një të shkuare që ka prodhuar kaq shumë thesare vlerash historike, shkencore dhe kulturore me përmasa botërore, si një identitet solid dhe i patjetërsueshëm i kombit tonë autokton ndër mijërvjeçarët e historisë së qytetërimeve dhe kombeve të njerëzimit deri më sot.

Shqipëria është një vend me histori të lashtë ndër qytetërimet antike, dhe me një histori shumë të pasur vlerash njerëzore dhe kulturore. Në periudha të ndryshme të historisë, në vendin tonë janë kryqëzuar qytetërimet, kulturat dhe besimet religjioze më të rëndësishme të historisë së njerëzimit. Prandaj trashëgimia jonë kulturore, është shumë e pasur në krahasim me përmasat gjeografike të vendit tonë, dhe është një dëshmi e qartë e një të shkuare që ka prodhuar kaq shumë thesare vlerash historike, shkencore dhe kulturore me përmasa botërore, si një identitet solid dhe i patjetërsueshëm i kombit tonë autokton ndër mijërvjeçarët e historisë së qytetërimeve dhe kombeve të njerëzimit deri më sot.

Çfarë kuptojmë me trashëgimi kulturore?

Me trashëgimi kulturore kuptojmë të gjithë pasurinë kulturore materiale dhe jo materiale, të luajshme dhe të paluajshme, shpirtërore dhe burimore gojore, si një tërësi vlerash kombëtare të ruajtura ndër breza që nga lashtësia jonë historike e deri më sot, si një mbartëse besnike dhe reale e kujtesës tonë historike, dhe treguese e qartë identitetit tonë kombëtar, e vlerësuar maksimalisht nga UNESCO si një thesar vlerash botërore, me rëndësi historike studimi shkencore dhe kulturore për njerëzimin, e cila mbrohet ligjërisht nga shteti dhe organizata botërore e trashëgimisë kulturore siç është UNESCO. Sot në trevat shqiptare numërohen një numër i madh monumentesh historike dhe kulturore të konstatuara nga zbulimet arkeologjike tokësore dhe nënujore, që dëshmojnë historinë e qytetërimit tonë të lashtë, që datojnë mijëra vjet përpara erës sonë. Me teatro dhe amfiteatro si ai i Butrintit, Apolonisë, Bylisit etj., mbi 20 kala dhe kështjella si ajo e Shkodrës, Drishtit, Vaut të Dejës, Lezhës, Krutës, Bashtovës, Rodonit, e Ali Pashë Tepelenës në Porto Palermo, e Kaninës, Mërgëlliqit, e Peqinit, Lëkurisit etj., ku një pjesë e këtyre kalave e kështjellave vazhdojnë të banohen edhe sot nga popullsia vendase, si kalaja e Elbasanit, Beratit, e Gjirokastrës, etj. Me mbi 220 objekte dhe ndërtesa kulti si tempuj, manastire, kisha dhe xhami, me mbi 7 000 ikona, dhe mijëra instrumente dhe artefakte kulturore, me qindra rrugë, ura, shtëpi dhe pazare të cilat vazhdojnë të jenë funksionale dhe të përdoren akoma edhe sot nga banorët e zonave ku ata ndodhen. Me dhjetëra zona natyrore si lugina, lumenj, parqe natyrore, pyje, liqene, laguna, si dhe gjire detare apo ishuj me vlera të rralla natyrore, arkitektonike dhe arkeologjike.

Trashëgimia kulturore shpirtërore shqiptare

Ndërmjet shumë elementeve të trashëgimisë tonë kulturore shpirtërore, bëjnë pjesë këngët, vallet, instrumentet muzikore, meloditë dhe ritmet e ndryshme, folklori gojor, prozat popullore, përrallat, anekdotat, gjëgjëzat, legjendat, tregimet historike, fjalët e urta, poezia popullore për të bukurën dhe të shëmtuarën, lojërat popullore me mjetet e nevojshme për realizimin e tyre, traditat zakonore dhe doket si miqësia, vëllazërimi, hasmëria, mikpritja, koncepti për besën, nderin, familjen, atdheun, kombësinë apo besimin fetar etj. Me ratifikimin nga Shqipëria të Konventës së UNESCO-s, në vitin 2006 "Për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Trashëgimisë Shpirtërore Shqiptare", ka ndikuar në një angazhim në rritje të shumë autorëve dhe donatorëve atdhetdashës për të ruajtur dhe përtërirë akoma më tej këto vlera të larmishme me rëndësi të veçanta si nga mënyra e krijimit ashtu dhe e realizimit, si thesare unike vlerash të krijuara ndër mijërvjeçarë historie njerëzore, duke krijuar kështu një nga kolonat bazë dhe kryesore të identitetit tonë historik dhe kombëtar.

Kryevepra të trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare Isopolifonia popullore shqiptare

Isopolifonia është folklori vokal, instrumental dhe koreografik dhe tipologji e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare, shpallur "Kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit" nga



UNESCO, më 25 nëntor 2005. Isopolifonia shqiptare është realisht një ndër super vlerat e folklorit muzikor shqiptar por dhe të traditës botërore folklorike në përgjithësi. Struktura e ndërtimit të shumëzërëshit polifonik, lab apo tosk, është shprehje e drejtpërdrejtë e unitetit gjenetik të llojit. Isopolifonia është dukuria bazë muzikore në Shqipërinë e Jugut, e cila ndërtohet mbi parimin e këndimit të një apo disa zërave të ndryshëm solistikë, mbi një shtrat isoje të kënduar nga grup këngëtarësh. Tipat kryesorë janë isopolifonia labe, isopolifonia toske dhe isopolifonia çame. Isopolifonia është 2-3 dhe 4-zërëshe, vokale, instrumentale dhe koreografike. Në Toskëri shumëzërëshin e gjejmë me këtë organizim strukturor: Zëri I - "ia hedh" - hedhësi ose

marrësi Zëri II - "ia pret" - pritësi Zëri III - "mbajnë zënë"; Iso në Labëri: (tre zërëshi) Zëri I - "ia merr" - marrësi Zëri II - "ia kthen" - kthyesi Zëri III - "ia mbush" - mbushësit; Iso (katër zërëshi) Zëri I - "ia merr" - marrësi Zëri II - "ia kthen" - kthyesi Zëri III - "ia hedh" - hedhësi Zëri IV - "ia mbush" - mbushësit.

Prej praktikës qindra shekullore janë ndërtuar formulat e mësipërme të cilat shprehin në thelb strukturën e isopolifonisë popullore, ajo e cila ngërthen në një të vetëm tiparet e veçanta të zërave të tjerë, përbërës të shumëzërëshit. Për sa i përket shtrirjes gjeografike të Labërisë, sipas Çabej: "me këtë emër quhet ajo pjesë toke jugperëndimore, kufiri i së cilës fillon te katundi Lazarat në jugë të Gjirokastrës.

Instrumentet tradicionale popullore

Lahuta

Është një vegël popullore me hark dhe me një kordë të përbërë prej qimeve të kalit. Është një ndër instrumentet më të lashta të trashëgimisë tonë kulturore shqiptare, ku përdorimi i saj njihet qysh mbi 1000 vite p. e. s. Vetë etimologjia e emrit të këtij instrumenti tradicionalisht autokton shqiptar formohet nga 2 rrokje: la + hut, që e përthyer nga pellazgishja e hershme ka kuptim akoma sot në gegnisht, që do të thotë që ky instrument të lë të hutuar, pra la-hut. Edhe Homeri, që në pellazgisht emri i tij kuptohet si (i mjeri), pasi ka qenë i verbër, ka qenë 100% pellazg dhe ka jetuar në vitet 700-800 p. e. s., kur helenët apo "Greqia e lashtë" historikisht nuk kanë ekzistuar fare. Homeri ka kënduar poemat e tij epike nën shoqërimin e lahutës, duke e rrëfyer në pellazgisht historinë e luftës së famshme të Trojës (shek. X - XI p.e.s.) kur Greqia apo fiset helene nuk ekzistonin akoma si qytetërim në Ballkan. Pavarësisht se Iliada u shkrua (rreth 400 vite pas vdekjes së Homerit) nga sundimtari grek Psastru në shek. III p.e.s. (rreth 400 vite pas vdekjes së Homerit) duke tjetërsuar poemat e tij epike dhe historitë e Trojës si histori greke, ku është fakt i pakontestueshëm që edhe sot, si titulli ashtu edhe personazhet e ILIADES përsëri kanë emra pellazgë me domethënie shqip dhe nuk kanë asnjë kuptim etimologjik në gjuhën greke as atë të lashtën e folur dhe assesi atë greqishte të sotme. Historia është treguar e padrejtë me trashëgiminë autoktone të këtij instrumenti, pasi nga neglizhenca e institucioneve politike dhe kulturore shqiptare, UNESCO ia njohu këtë instrument Serbisë, kur dihet historikisht se sllavët janë popullsi e ardhur nga Uralet ruse rreth 1200-1300 vite më parë, ndërkohë që ky instrument i lashtë mbi 3 000 vjeçar dhe autokton shqiptar, nuk ka asnjë traditë dhe nuk njihet fare si instrument në Uralet ruse apo më gjerë, nga ato zona prej nga ku sllavët erdhën në Ballkan.

Trupi i lahutës përbëhet nga një copë e vetme druri (panje, arre, etj.). Kasa ka trajtë gjysmë sferike dhe mbulohet me lëkurë të regjur e cila mbërthet në anët e saj me kunjat druri. Harku i lahutës bëhet zakonisht nga druri i thanës, qimet lyhen me rrëshirë pishë. Lahuta shpesh herë është e zbukuruar me simbole kultesh të lashta si koka e dhisë, gjarpri, ose figura historike etj. Timbri i lahutës është hundor dhe përshatet shumë mirë me përmbajtjen e këngëve epike. Me lahutë luhen hyrjet, interludet dhe shoqërohet në mënyrë heterofonike këngëtarit. Lahuta është e përhapur në Malësinë e Madhe, Dukagjin, Postrib, Nikaj-Mertur, në Malësinë e Gjakovës etj. Ndeshet edhe në krahinat poshtë Drinit si në Puke, Dibër, Mat dhe aty këtu në disa fshatra të Shqipërisë së Mesme.

Çiftelia

Është vegël muzikore popullore me dy tela, që i bie me pendë. Njihet edhe me emrat: dyzen, karadyzen, në disa raste e quajnë edhe me emrin e tamrës ose tamburasë. Ka tri pjesë: kupa, kapaku dhe bishiti, madhësitë dhe trajtat ndryshojnë sipas krahinave. Tipi kryesor i çiftelisë është me dy tela, zakonisht akordohet në kuart, përdoret gjithashtu edhe në sekondë, lart dhe poshtë, kuinte, unison dhe septim. Penda zakonisht nxirret nga lëkura e trugut të qershisë. Loja përqendrohet në telin e parë, teli i dytë përdoret si mbështetje ritmike harmonike në trajtën e isos. Ka edhe raste që teli i dytë i çiftelisë përdoret për kalimet e vështira melodike, kryesisht nga instrumentistë virtuozë. Në repertorin e çiftelisë përfshihen këngët lirike, shoqërohen dhe vallet.

Fleta

Është instrumenti më i vjetër në agjendën e instrumenteve popullore shqiptare. Me tingullin magjepsës që lëshon ky instrument i thjeshtë, radhitet e para tek instrumentet frymore. Në kohët e lashta kur teknika dhe kushtet nuk ishin të mira, shqiptarët argëtonin veten dhe të tjerët me melodinë e fletës së dushkut. Më shumë e përdornin barinjët, ku meloditë jehonte bleshkë pas bleshke, pasi që

Kufiri lindor shkon prej Lazaratit për së gjati Malit të Gjerë dhe pjesës jugore të Malit të Picarit gjer në Tepelenë. Kështu vazhdon në përfundim të Vjosës kurse në të djathtë të lumit shtrihet vendi toskë në kuptimin e vërtetë të ngushtë të fjalës. Kufiri zë në veri katundin Mesaplik afër Vlorës dhe vazhdon gjatë një vije ideale që shkon prej Mesaplikut në Kudhësin e afërm; kufirin përfundimor e përbën deti".

Instrumentet e muzikës sonë popullore, janë një thesar tjetër i trashëgimisë tonë kulturore. Disa prej tyre si gjethja apo lahuta që datojnë mbi 3 000 vite më parë në fillimet e Eposit tonë Epik Legjendar apo Historik, pra rreth 3 000 vite më parë. Në varësi se si këto vegla muzikore krijojnë tingujt e tyre, ato i grupojmë në: 1) Kordofonet - me tela, 2) Aerofonet - frymore, 3) Idiofonet - me kërcitje, dhe 4) Membranofonet - me lëkurë/membrane. Në instrumentet kordofone tingulli përftohet nga lëkundja e kordave të tërhequra. Kanë dy nëndarje: a) kordofone me pendë, si: çiftelia, bakllama, sharkia, sazja, çyri dhe llauta, dhe b) kordofone me bark, si: lahuta dhe lauria. Me përjashtim të lahutës, që përdoret vetëm për shoqërimin e këngëve të epikës heroike dhe historike, veglat e tjera përdoren me funksione të shumëllojshme. Shoqërojnë këngëtarët popullore e vallet, si dhe luajnë motive solistike. Vitet e fundit këto po përdoren gjerësisht në formacionet

instrumentale popullore. Në përmbajtjen e repertorit të tyre vihet re një karakter i theksuar lirik dhe optimist. Në Instrumentet Aerofone tingulli përftohet nga lëkundjet e ajrit. Veglat e kësaj gjinie duke përfshirë edhe ato para-muzikore, janë të shumëllojshme dhe kanë përhapje të ndryshme. Të tilla janë: gjethi, pipëza, zamarja, gajdja, fyelli, surlja etj. Repertori muzikor i tyre dallohet për karakterin kombëtar. Janë të përhapura në gjithë vendin për shumë role. Në Instrumentet Idiofone tingujt përftohen nga lëkundjet e trupit të tyre të ngurtë nëpërmjet përplasjes, fërkimit, tundjes ose pickimit (rraketakja, rrakeza, zereza, tepsia, lugët, këmborët, zilet etj.). Shumica e tyre janë përdorur për të argëtuar foshnjat. Në muzikën popullore më të shumtën e rasteve kanë rolin shoqëruar të këngëve, valleve, instrumenteve dhe formacioneve instrumentale popullore (lugët, çaparet, tepsia etj.). Vetëm ndonjë prej tyre është përdorur si solistike (p.sh. cungrana). Në Instrumentet membranofone, tingulli përftohet nga një cipë ose lëkurë e tërhequr. Njihet si të tilla: tumbullaci, qypi, dajrja, lodërtia dhe poçi. Përdoren kryesisht për shoqërim. Përveç dajres (defit) që përdoret kudo nga gratë e burrat për shoqërimin e këngëve të dasmës, të tjerat përdoren kryesisht në disa rrethe të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut për shoqërimin e valleve, si dhe në formacione instrumentale popullore.

fleta ka një tingull depërtues. Më mirë bie fleta e ahut, por nëse nuk gjendet mund të zëvendësohet edhe me fletë të tjera si të arrës, lajthisë, mollës, qershisë etj.

Mesme

Është vegël frymore me gjuhëz të njëfishtë. Përbëhet nga tri pjesë: pipëza, trupi dhe briri. Trupi i zamares bëhet prej kocke të krahut të shpikës ose shqiponjës, prej kallami ose gypi tjetër; pipëza bëhet me kallama dhe briri (pjesa e fundit) nga briri i lopës. Në trupin e veglës hapen 4-6 vrime paralele (homofonike), ndërsa në zamaren diafonike në njërin gyp hapen 4-6 vrime dhe në tjetrin një vrime. Gypi i dytë shërben për të mbështetur melodinë me iso. Përftohet një shkallë përkatësisht penta, hezka dhe heptakordale, si dhe shkallë të tjera që i përkasin gjinisë tonale. Zamarja luhet duke i fryrë vazhdimisht, prandaj kërkohet një teknikë e veçantë. Tingulli i zamares është i fuqishëm, me timbër therës dhe pak hundor. Meloditë që luhen me zamare janë zakonisht të kufizuara për shkak të diapazonit të vogël. Janë melodi këngësh e vallesh, si dhe improvizime të lira. Përdoret kryesisht në krahinat veriore si në Lezhë, Pukë, Shkodër, Mirditë, etj. Burimet historike dëshmojnë për përdorimin e kësaj vegle që në shek. VII-VIII të erës sonë.

Fyelli

Vegël muzikore popullore me frymë e përhapur në të gjitha krahinat, e njohur sidomos si vegla e barinjve. Trajtat dhe emërtimet e fyellit janë të shumta: cirifilja dhe culja e Labërisë; duduku i Shqipërisë Jug-Lindore; kavalli, që përdoret më shumë në rrethin e Gramshit; bilbili, i përhapur në mbarë vendin; xamarapo xura në Çamëri; fishkaroli dhe floyera te arbëreshët etj. Madhësia e fyellit ndryshon sipas llojeve, nga 18 cm (fyelli i shkurtër) deri në 90 cm (kavalli). Fyelli ndërtohet prej drurit të bushit, të shtogut, të panjës, të arrës, por edhe nga gypa metalike, sidomos prej tunxhi e bronzi. Fyelli përdoret kryesisht nga burrat. Repertori i fyelltarëve përbëhet nga motive të mirënjohura këngësh e vallesh, nga pjesë solistike të marra nga vajtimet e grave etj. Figurat muzikore dhe emërtimet e pjesëve instrumentale për fyell lidhen zakonisht me mjediset blegtorale, si "Dhentë në kullotë", "Dhentë në mri", "Dhentë tek burimi", "Zilet e dhenve" etj. Tingujt e fyellit kombinohen bukur me të këmborëve dhe të zileve të bagëtive gjatë kullotës. Shpesh bashkohen dy fyej, ku njëri prej tyre luan melodinë dhe tjetri mban iso.

Gajdja

Është një instrument muzikor që përbëhet nga shakulli prej lëkure bagëtie të vogël, buçalla e isos dhe pipa e notave. Gajdja tek shqiptarët është e lidhur ngushtë me kultin e blegtorisë. Për këtë arsye, repertori i gajdes përkon ngushtë me këtë sferë të jetës shqiptare. Që në kohët e vjetra sipas Thallosy-it: "ilirit këndonin këngë lufte të shoqëruara me fyej e gajde. Sot, gjeografikisht gajdja gjendet e përhapur në Shqipërinë e Jugut, kryesisht në Toskëri, në rrethet e Beratit, Kuçovës, Pogradecit, Gramshit, Devollit, Korçës, Librazhdit etj. Përdoret si vegël solistike në pjesë të ndryshme, kryesisht kaba, por edhe si vegël shoqëruese në ansamble me vegla popullore kryesisht në funksion të melodisë dhe veçanërisht të iso-pedalit. Si vegël popullore mjaft e përdorur dhe e përhapur, e gjejmë të ndërfutur edhe si "të panjohur" në gjëgjëzat.

Daullja - Tupani

Është një ndër veglat më të hershme të muzikës sonë popullore, e përdorur gjerësisht në të gjitha trevat shqiptare, për shoqërimin e valleve si një udhëheqës ritmik për vallet pa shoqërim instrumental melodik, ashtu edhe në ato me shoqërim melodik nga veglat e tjera tradicionale si çifteli, sharki, surlja, zamarja etj.

Ilariteti kulturor mes krahinave ka sjellë prej antikitetit e deri në ditët tona këto thesare të çmuara folklorike të cilat duhet t'i ruajmë fort prej ndikimeve "moderniste" të cilat po ndikojnë në formatin e tyre universal, mes kompozimesh delirante.



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTA

Strategjia ushtarake e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit


Lidhja Shqiptare e Prizrenit u themelua dhe veprroi prej 10 qershorit të vitit 1879 deri më 30 prill të vitit 1881, në periudhën e krizës që kishte përfshirë Lindjen. Kriza Lindore e viteve 1877-1878 e shoqëruar me përfundimin e luftës ruso-turke dhe disfatën e Turqisë, përkeqësoi autoritetin dhe aftësitë e kësaj perandorie për të ruajtur sferën e influencës mbi shtetet që kishin qenë pjesë e saj. Situata e krijuar me Turqinë dhe veçanërisht vendimet e Kongresit të Berlinit, të vitit 1878, i cili parashikonte copëtimin e trojeve shqiptare në interes të vendeve fqinjë, shtoi rrezikun për Shqipërinë. Në këto situata, Fuqitë e Mëdha dhe fqinjët shovinistë të Shqipërisë nuk njohën kombin shqiptar dhe nxituan ta copëtonin atë. Lidhja Shqiptare e Prizrenit mëshiroi në të njëjtën kohë edhe vetë lëvizjen kombëtare që zhvilloi populli shqiptar për të realizuar programin e Rilindjes Kombëtare.

E lindur në situata kërcënime e agresione, Lidhja qysh në fillimet e saj mori përmbajtjen e një organizate politike me karakter të theksuar luftarak. Synimi i saj kryesor ishte të mos lejonte copëtimin dhe aneksimin e tokave shqiptare nga shtetet fqinje dhe të arrinte shpalljen e autonomisë nga Porta e Lartë. Meqenëse kërkesat e Lidhjes nuk u morën parasysh, lufta me armë për mbrojtjen e territoreve shqiptare u bë objektivi kryesor politik dhe ushtarak i veprimtarisë së saj.

Koncepti strategjik ushtarak

Lidhja në përputhje me strategjinë politike, si qëllim kryesor të luftës, përcaktoi mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe thyerjen e çdo agresioni të mundshëm nga jashtë. Nisur nga ky qëllim, lidhja përcaktoi edhe konceptin strategjik, thelbin e të cilit e përbënte kryesisht karakteri mbrojtës i luftës, por pa hequr dorë nga lufta për çlirimin dhe rimarrjen e territoreve të pushtuara nga Mali i Zi dhe Serbia gjatë viteve 1877-1878. Në këtë kuadër ajo formuloi edhe strategjinë e saj ushtarake, objektivat kryesorë të së cilës ishin: organizimi dhe kompletimi i ushtrisë vullnetare; pajisja dhe armatimi i saj; hartimi i planeve për mbrojtjen e territoreve si dhe të kundërmësymjes për çlirimin dhe rimarrjen e territoreve të pushtuara; organizimi i prapavijës dhe zgjidhja e problemeve të drejtimit etj.

Në kërkesat e saj për mobilizimin e burimeve njerëzore, lidhja synonte për një angazhim mbarëkombëtar, baza kryesore e të cilit do të ishte vullnetarizmi i tyre. Kriteri bazë i mobilizimit mbështetej në traditën shumë shekullore "një luftëtar për shtëpi", por në raste të situatave kritike dhe në krahinat kufitare shpesh gjente zbatim parimi "tre luftëtarë për shtëpi". Forcat e Armatosura do të quheshin "Roja Kombëtare" dhe bazuar në regjistrimin e popullsisë të bërë nga Lidhja do të arrinte në 260 000 veta. Në varësi të situatës, koncepti për mobilizimin e popullsisë do të realizohej i pjesshëm dhe i përgjithshëm. Mobilizimi i pjesshëm do të bëhej për kompletimin e reparteve dhe njësisve që do të përdoreheshin për mbrojtjen e zonave kufitare në rast mësymje të armikut. Mobilizimi përfshinte moshat 15-70 vjeç. Të mobilizuarit, grumbulloheshin në "Kampe Ushtarake", në të cilat pas organizimit në reparte



dhe njësi, i nënshtroheshin stërvitjes ushtarake. Qendra të tilla u krijuan në rajonet kufitare si në Ulqin, Shkodër, Plavë, Guci, Pejë, Novipazar, Gjakovë, Shkup etj.

Korpuse dhe divizione ushtarake, një risi shqiptare

Struktura e "Rojës Kombëtare" do të përbëhej nga pesë korpuse, prej tyre katër në Shqipërinë e Veriut dhe një në Shqipërinë e Jugut. Çdo korpus do të përbëhej nga disa brigada dhe në tërësi do të ishin forca këmbësorie. Në disa drejtime forcat e Lidhjes u përforcuan me artileri, mjete lundruese, ndërlydhe, shërbim të zbulimit, reparte shëtitëse dhe reparte të mbrojtjes së kalave. Në planet e Lidhjes kërkoheshin që në çdo batalion këmbësorie të formohej kompania kalorëse e cila do të përdorej për transport njerëzish dhe të materialeve luftarake.

Strukturat e mëdha ushtarake, korpuse dhe divizioni nuk konceptoheshin si njësi të përhershme. Ato qëndronin të grumbulluara për aq kohë sa vazhdonte kërcënimi për luftë. Karakteristikë është se strukturat dhe organikat luftarake ishin përcaktuar me detaje. Çdo njësi, repart e nënrepart kishte të përcaktuar strukturën vartëse, sasinë e luftëtarëve, strukturat mbështetëse, nivelin e gradave të drejtuesve etj. Sipas organikave të përgatitura çdo kompani do të kishte 100 luftëtarë; batalioni do të kishte katër kompani këmbësorie dhe një kompani kalorësie me efektiv të përgjithshëm 500 veta; një regjiment do të kishte katër batalione me efektiv të përgjithshëm 2000 veta; ndërsa brigada do të kishte 4000 veta. Në raste situatash të ngutshme strukturat mund të reduktoheshin, kështu batalioni mund të kishte 3000 veta, regjimenti rreth 1200 veta dhe brigada rreth 250 veta. Sipas përllogaritjeve të Lidhjes "Rojë Kombëtare" do të kishte 380 batalione në Shqipërinë e Veriut dhe 100 batalione në Shqipërinë e Jugut. Në pikëpamje të përdorimit të forcave sipas nevojave për përballimin e kundërshtarit, lidhja ngriti një sistem të admirueshëm gatishmërie, i cili përfshinte forcat e ruajtjes, zbulimit, sig-

urimit, të përballimit të agresionit etj.

Mobilizimi i përgjithshëm

Në varësi të veprimeve të kundërshtarit, të kohës së nevojshme për futje në luftim, largësisë së rajoneve të mobilizimit, forcat e gatishmërisë ndaheshin: të radhës së parë, të dytë dhe të tretë. Forca të radhës së parë ishin repartat kufitare, të ruajtjes dhe të zbulimit, të cilat zakonisht formoheshin nga vullnetarët e popullsisë kufitare. Detyra kryesore e këtyre reparteve ishte vrojtimi, zbulimi dhe pengimi i kundërshtarit. Forca të radhës së dytë ishin forcat që formonin njësitë kryesore për mbrojtje. Ato formoheshin nga vullnetarët, nga popullsia në thellësi të territorit të vendit dhe organizonin mbrojtjen për të përballuar mësymjen e armikut. Forca të radhës së tretë ishin forcat e rezervës strategjike dhe dilnin nga viset e thella të vendit. Detyra kryesore e tyre ishte përforsimi i mbrojtjes dhe dhënia e kundërgoditjeve dhe kundërmësymjes. Në planin e lidhjes, forcat e Shqipërisë së Mesme ku bënin pjesë popullsia e Matit, Krujës, Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit përbënin rezervat strategjike të Lidhjes dhe do të përdoreheshin për në përforsimin e mbrojtjes në drejtim të Shkodrës si dhe do të merrnin pjesë në kundërmësymjen për të rimarrë territoret e pushtuara nga Mali i Zi.

Koncepti për prapavijën

Në konceptin e saj për mbështetjen, lidhja krijoi aparatit të prapavijës, i cili do të merrej me sigurimin e armatimit, municionit, ushqimit, veshmbathjes, strehimit të efektiveve etj. Në krye të këtij aparati qëndronte një komision i cili kishte strukturat vartëse në çdo krahinë. Këto komisione kishin në varësi reparte speciale shëndetësore, transporti dhe ruajtje.

Drejtimi dhe organizimi më i lartë ushtarak i Lidhjes ishte Seksioni i Financës dhe i Mbrojtjes. Ky seksion mori formën e një Këshilli dhe Shtabi Ushtarak Madhor, duke vepruar kështu deri në fund të aktivitetit të Lidhjes më 1881, kohë kur Lidhja u shtyp nga ushtria turke. Seksioni i mbrojtjes kishte për detyrë të hartimit të planeve dhe urdhrave për mobilizimin dhe plotësi-

min e formacioneve luftarake; të organizimit e të kontrollit të gatishmërisë; të drejtimit e bashkëveprimit strategjik etj. Ky sektor drejtohej nga Sulejman Vokshi dhe aktiviteti i tij drejtues u ndje në njësitë e Shqipërisë Veriore, Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit, Dibër dhe Shkupit. Organe drejtuese politiko-ushtarake të një shkalle më të vogël ishin "Komitetet e Mbrojtjes" të degëve kryesore të Lidhjes. Këto komitete kryesisht morën karakterin e shtabeve ushtarake dhe u morën me problemet e organizimit të mbrojtjes. Në situata të veçanta këto komitete edhe shtabe ushtarake speciale të cilat merreshin me drejtimin e operacioneve të veçanta u quajtën edhe "Komitete shpëtimi", "Qendra të operacioneve", ose "Këshillat e oficerëve të divizioneve" etj. Zgjedhja dhe përcaktimi i kuadrit komandues u vlerësua si një nga çështjet më serioze në organizimin e strukturave ushtarake. Udhëzimet e dhëna nga Lidhja ishin që përzgjedhja të bëhet nga njerëzit që kishin aftësi, përvojë dhe autoritet. Zgjedhja e tyre të bëhet vetëm me pëlqimin e popullsisë. Një kontingjent i mirë komanduesish ishin dhe ish-ushtarakë shqiptarë që kishin shërbyer më parë në ushtrinë turke.

Drejtimet kryesore strategjike

Për realizimin e objektivave ushtarake, Lidhja formuloi edhe "Planet Strategjike", qëllimet e të cilave shprehen qartë në urdhëresën ushtarake të saj të 18 qershorit 1878 ku parashikonte: "... ndarje pune për mbrojtjen e trojeve të Shqipërisë prej veriut deri në jug, ndihmën ushtarake të shoqishoqme". Në planet strategjike jepën udhëzime për organizimin e mbrojtjes me drejtime të përcaktuara strategjike. Drejtimet kryesore strategjike u vlerësuan ai kundër Malit të Zi dhe Serbisë e më pas vinte ai Greqisë. Në këtë kuadër ishte parashikuar edhe ndarja e përgjegjësisë dhe detyrave operacionale të strukturave ushtarake që kishte Lidhja. Kështu Korpusi i Kosovës, i cili parashikoheshin të arrinte 70 000 veta duhej të mbronte një front prej 250 km. Detyra kryesore e tij ishte përballimi i mësymjes Serbe, si dhe kalimi në kundërmësymje për

marrjen e territoreve të pushtuara nga serbët para vitit 1878. Korpusi i Shkodrës, i cili parashikoheshin të arrinte 60 000 veta duhej të mbronte një front prej 200 km. Detyra kryesore e tij ishte përballimi i mësymjes malazeze, si dhe kalimi në kundërmësymje për marrjen e territoreve të pushtuara të tyre. Korpusi i Shkupit i cili parashikoheshin të arrinte 40 000 veta duhej të mbronte një front prej 40 km. Detyra kryesore e tij ishte mbrojtja në drejtim të Bullgarisë. Ky korpus ishte parashikuar të përforsonte Korpusin e Kosovës për mbrojtje si dhe gjatë pjesëmarrjes në kundërmësymje. Korpusi i Shqipërisë së Jugut, i cili parashikoheshin të arrinte 70 000 veta, detyrë kryesore të tij kishte përballimin e agresionit grek. E veçanta ishte se mbrojtja në këtë drejtim parashikoheshin me sektorë të veçantë. Korpusi i Novipazarit, i cili parashikoheshin të arrinte 20 000 veta, do të shërbente si forcë plotësuese e Korpusit të Kosovës dhe atij të Shkodrës dhe nuk kishte front të veçantë mbrojtje.

Vlerësimi real i terrenit, veçanërisht i viseve kufitare shqiptare ku pjesën dërmuese të tij e përbënte terreni i thyer malor, bëri që organizimi i mbrojtjes të bëhet me drejtime, duke mbuluar rrugëkalimet dhe luginat kryesore. Kjo bëri që fronti i vendosjes për mbrojtje të zvogëlohej dhe njëkohësisht krijonte mundësi të kursimit të forcave të cilat mund të përdoreheshin në drejtime të tjera. Në kuadër të parashikimit të kalimit në kundërmësymje veçanërisht në drejtim të Malit të Zi dhe Serbisë Lidhja parashikoi jo vetëm sasinë e forcave pjesëmarrëse, por edhe masat që do të shoqëronin këto operacione si mbështetja dhe sigurimi i prapavijës materialo-teknike, kryerja e manovrës së forcave, organizimi i bashkëveprimit midis njësisve të mëdha etj.

Sfidë për armiqet

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte në të njëjtën kohë një lëvizje kombëtare e mbarë shqiptarëve, të cilët kudo që u ndodhën, në qytet apo në fshat, në malësi apo në fushë, në atdhe apo në mërgim, luftuan për të realizuar programin e saj, pavarësisht nëse bënin pjesë në hallkat e saj organizative.

Veprimtarinë e saj trevjeçare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit e zhvilloi në rrethana politike të brendshme dhe të jashtme më të ndërlikuara se ato të lëvizjeve anti-osmane të shekujve të kaluar. Këtë radhë shqiptarët patën kundër tyre jo vetëm Perandorinë e Gjysmëhënës, jo vetëm qarqet feudale dhe klerikale sulltaniste, por edhe reaksionin ndërkombëtar, të gjitha Fuqitë e Mëdha që diktonin fatin e popujve të vegjël së bashku me monarkitë fqinje ballkanike. Madhështia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit qëndron në faktin se duke vepruar në kushtet e zgjidhjes shekullore të huaj ajo ishte një sfidë ndaj të gjithë armiqve të Shqipërisë. Madhështia e saj qëndron në udhëheqjen e lëvizjes kombëtare për autonominë e Shqipërisë në mënyrë të shkallëzuar por gjithnjë në rritje, derisa arriti në momentin e saj kulmor, të formonte qeverinë e përkohshme shqiptare dhe të hynte në luftë të armatosur me Portën e Lartë për të formuar shtetin kombëtar shqiptar.

Filluan regjistrimet e kandidatëve për ushtarë/ detarë aktivë në FA për periudhën 12 shtator - 18 nëntor 2022 sipas rajoneve



Qendra e Personel-Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura



Qendra e Personel-Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 12.09.2022 - 18.11.2022, gjithsej 346 kandidatë, (332 meshkuj dhe 14 femra), sipas rajoneve përkatëse në tabelën bashkëlidhur.

Për më Shumë Informacion drejtohuni tek linku i mëposhtëm:
<https://www.mod.gov.al/.../5539-filluan-regjistrimet-e...>



Qendra e Personel-Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2022-2023, për 40 (dyzet) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimi universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik, Financë), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Jurist (Fakulteti i Drejtësisë), Transport (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike), Këmbësori/Zbulim (Shkenca sociale/Fakultetet e tjera).

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 11 gusht 2022.

Për më Shumë Informacion drejtohuni tek linku i mëposhtëm:
<https://www.mod.gov.al/.../5540-qendra-e-personel...>